

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7147
E enjte, 21 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Letër e hapur krerëve të shtetit
Veproni me urgjencë në mbrojtje të republikës!

FAQE 6-7



Dr. Hajdin ABAZI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË KOSOVË,
JEFF HOVENIER, U ËSHTË PËRGJIGJUR DEKLARATAVE KËRCËNUESE
TË PRESIDENTIT SERB ALEKSANDËR VUÇIQ | FAQE 4-5

KOSOVA KA GARANCI TË FORTA TË SIGURISË NGA SHBA-ja SI KURRË MË PARË



Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, pas takimit që ka pasur të mërkurën me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, ka folur për deklaratat e fundit kërcënuese të presidentit

serb Aleksandër Vuçiq, me "pushtimin e mundshëm të Kosovës". Hovenieri ka theksuar se populli i Kosovës nuk duhet të ndihet i shqetësuar nga këto deklarata. "Mund të them që

përkushtimi ynë për sigurinë e Kosovës, garancitë e sigurisë që ShBA-ja ka ofruar, qëndrojnë të forta si kurrë më parë. Ne flemë rehat sa i përket këtij kërcënimi", ka thënë Hovenieri

AKTUALE



BE-JA MUNDËSON QASJE PA TARIFA
TË IMPORTEVE UKRAINASE F. 2

OSMANI I KUNDËRPËRGJIGJET
HILLIT: SERBIA ËSHTË LARG NATO-S

F. 3

NEGOCIATAT NË BRUKSEL PËR
DINARIN, PALËT PAJTOHEN
TË OFROJNË PROPOZIME TEKNIKE
DERI MË 22 MARS F. 5

EKONOMI



KOSOVA DHE GJERMANIA
NËNSHKRUAJNË DEKLARATËN
E PARTNERITETIT PËR KLIMËN
DHE ENERJINË F. 8

UNDP-JA CERTIFIKON TRAJNERËT
PËR INSTALIMIN E PANELEVE SOLARE

F. 8

SPORT



ALITI DHE RRAHMANI: NA PRESIN DY
NDESHJE TË RËNDËSISHME F. 10

MANASTIRI
I DEÇANIT
REGJISTRON
PRONËSINË
E 24 HEKTARËVE
TOKË F. 3



KOZ-ja KËRKON
BUXHET SHITESË
PËR BLERJEN
E KAMERAVE
VËZHGOESE NË
VENDVOTIME F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja mundëson qasje pa tarifa të importeve ukrainase

BRUKSEL, 20 MARS - Bashkimi Evropian ka arritur një marrëveshje të përkohshme më 20 mars që u jep prodhuesve ushqimorë ukrainas qasje pa tarifa në tregun evropian deri në qershor të vitit 2025, megjithëse ka kufizime të reja në importet e drithërave. Komisioni Evropian propozoi në janar t'i pezullojë detyrimet dhe kuotat në prodhimin e fermave ukrainase edhe për një vit tjetër, me një "frenim urgjent" për shpendët, vezët dhe sheqerin, duke çuar në vendosjen e tarifave nëse importet tejkalojnë nivelet mesatare të vitit 2022 dhe 2023. Megjithatë, pas disa muajsh protesta të fermerëve lidhur me

rregullat mjedisore të BE-së dhe për importet e lira, ligjvënësit e BE-së shtyn përpara zgjerimin e listës urgjente në prodhimin e importeve të tjera bujqësore dhe shtuan vitin 2021 si vit referimi. Një gjë e tillë u parapara para se Rusia ta niste pushtimin e Ukrainës, kur eksportet ukrainase në BE u frenuan nga tarifatat dhe kuotat. Negociatorët nga Parlamenti Evropian dhe Presidenca belge e BE-së u pajtuan mëngjesin e së mërkurës që t'i shtojnë në listë tërshërën, misrin, drithërat dhe mjaltin, duke mbajtur kufizimin e mesatares së importeve të vitit 2022 dhe 2023. Negociatorët u pajtuan që



Komisioni do të vepronte brenda 14 ditësh, në vend se 21 ditë sa ishte paraparë fillimisht, nëse do të arriheshin nivelet e duhura të

importeve. Fqinjët e Ukrainës që janë në BE - Bullgaria, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Sllovakia - janë

ankuar se importet bujqësore kanë zemëruar prodhuesit e tyre, duke çuar në protesta të fermerëve dhe ndalesa të importeve. Dërgesat në këto shtete janë rritur pasi nisja e pushtimit rus të Ukrainës pengoi eksportet përmes rrugës tradicionale të Detit të Zi. Kievi tha se eksportet bujqësore nuk po dëmtojnë tregjet në BE, veçmas tani që 95 për qind e eksporteve bujqësore të Ukrainës kalojnë përmes Detit të Zi. Ukraina, po ashtu, tha se vendimi i BE-së është i pranueshëm. Kjo marrëveshje e përkohshme duhet të miratohet nga Parlamenti Evropian dhe qeveritë e BE-së dhe vendimi për të ka gjasë të merret në prill.

Shqetësim mbi përdorimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike nga të miturit në Shqipëri

TI RANË, 20 MARS - Në Shqipëri ka një shqetësim në rritje mbi përfshirjen e të miturve në prodhimin dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike. Çdo vit rreth 100 të mitur, sipas të dhënave të policisë, bien pre e kësaj vepr penale. Autoritetet kanë shtuar përpjekjet për parandalimin dhe goditjen e fenomenit, ndërsa një nxënëse që kërkoi të mbetej anonim, dëshmoi se si bashkëmohatarët e saj janë kthyer në shpërndarës dhe përdorues të drogave të ndryshme. "Është fenomen tmerrësisht i frikshëm, për faktin se ti e sheh se

si ajo drogë e ndryshon personin. Kam njohur njerëz që i filluan këto rrugë dhe ndryshuan në mënyrë thelbësore. Dhe trembesh sepse nuk është në fuqinë tënde. Frika më e madhe ishte që nuk mund t'i ndihmoja dot", u shpreh Mirela, (emër jo i vërtetë), nxënëse në një shkollë të mesme. Pamundësia për të ndihmuar shokun apo shoqen e mitur që bie pre e përdorimit të lëndëve narkotike, është frika më e madhe e kësaj nxënëseje që vendosi të ndajë me Zërin e Amerikës, gjithçka di, ka parë dhe dëgjuar në mesin e bashkëmohatarëve të

saj, për këtë plagë të rëndë të shoqërisë shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare të policisë, në 5 vitet e fundit rreth 100 të mitur çdo vit, pjesa dërrmuese djem, janë përfshirë në aktivitetin e paligjshëm të prodhimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, rreth 90 % e tyre të moshës 15 deri në 17 vjeç. Edhe përse kjo shifër zë vetëm 4 % të totalit të personave të përfshirë në këtë vepr penale, sërish fenomeni është shqetësues duke marrë në konsideratë se kjo grupmohë është në shënjestër të grupeve kriminale për rekrutime, ashtu siç dëshmon dhe Mirela.



Shtatë të vdekur pas fundosjes së një cisterne në Japoni



TOKIO, 20 MARS - Shtatë persona kanë vdekur pasi një anije e Koresë së Jugut u fundos afër një ishulli në jugperëndim të Japonisë, thanë rojet bregdetare, duke shtuar se anija kishte nëntë anëtarë në ekuipazh. Rojet bregdetare ende po kërkojnë edhe dy persona që gjendeshin në cisternë me lëndë kimike, e cila u përmbys pasi kishte njoftuar se ishte përbullur me kushte të këqija në det. Për njërin prej tyre thanë se është ende gjallë, ndërsa gjendja e tjetrit ende nuk dihet. Rojet bregdetare thanë cisterna Keoyoung Sun kërkoi ndihmë,

pasi kishte raportuar se anija po anohej teksa po përballlej me kushte të këqija të motit afër ishullit japonez Mutsure. Ishulli gjendet pranë ishullit kryesor në jugperëndim të Japonisë, Honshu, rreth 1 000 kilometra larg Tokios. Derisa ekipet e shpëtimit arritën në skenë, anija veçse ishte fundosur, thanë rojet bregdetare. Pamjet e shfaqura nga televizioni NHK treguan anijen krejtësisht të kthyer përmbys. Kapitani i anijes ishte jugkorean, ndërsa në ekuipazh kishte edhe një tjetër anëtar nga Koreja e Jugut,

një shtetas kinez dhe tetë nga Indonezia, thanë autoritetet. Cisterna po bartte 980 tonë acid akrilik, thanë zyrtarët. Deri më tani nuk është vërejtur se ka pasur rrjedhje të lëndëve kimike, përdërisa autoritetet thanë se duhet të ndërmarrin masa për mbrojtjen e mjedisit në rast se do të ketë rrjedhje të lëndëve kimike. Acidi akrilik përdoret në plastikë, rrëshirë dhe veshje dhe mund ta iritojë lëkurën e sytë, sipas Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Shtetet e Bashkuara. Autoritetet nuk kanë dhënë më shumë detaje se si anija u fundos.

Pezullohet zbatimi i ligjit për migrantët në Teksas

El Paso, 20 mars - Planet e Teksasit që t'i arrestojë migrantët që dyshohet se hyjnë ilegalisht në Shtetet e Bashkuara u pezulluan sërish të mërkurën, përdërisa u krijua paqartësi përgjatë kufirit dhe zemërim në Meksikë pasi për disa orë ky ligj hyri në fuqi. Urdhri i lëshuar mbrëmjen e

së martës nga një panel i Gjykatës së Apelit në Qarkun e Pestë të Shteteve të Bashkuara sërish pezulloi ligjin. Më herët gjatë ditës, Gjykata Supreme lejoi zbatimin e ligjit të ashpër të emigrimit, duke inkurajuar shtetet e tjera që të ndërmarrin masa të ngjashme. Por, më vonë paneli i Apelit

sërish vendosi një pauzë para se të paraqiten argumentet gjatë një seance të caktuar për të mërkurën. Ende është e paqartë se kur mund të merret vendimi i ri për zbatimin e këtij ligji. Gjatë periudhës së shkurtër sa ligji ishte në fuqi të martën, autoritetet në Teksas nuk

njoftuan se kishin kryer ndonjë arrestim dhe nuk treguan nëse ligji po zbatohet në mënyrë aktive. Megjithatë, kjo u pa si një fitore e republikanëve që kanë shtyrë përpara këtë ligj. Në vendimin e Gjykatës Supreme u hodhën poshtë disa vendime të gjykatave më të

ulëta të apelit që ishin sfiduar nga Departamenti i Drejtësisë, i cili ka argumentuar se Teksasi po tejkalon kompetencat e qeverisë federale sa i përket imigracionit. Në vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit nuk u tregua arsyeja e panelit për pezullimin e ligjit.

Manastiri i Deçanit regjistron pronësinë e 24 hektarëve tokë

PRISHTINË, 20 MARS - Dioqeza e Rashkës dhe Prizrenit e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë konfirmoi se Manastiri i Deçanit ka regjistruar në emër të vet 24 hektarë tokë në Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë. “Në bazë të ekstraktit kadastral mund të konfirmojmë që është zbatuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2016 dhe Manastiri edhe në kadastrë njihet si pronar i tokës së kontestuar më herët. Me këtë ne mundemi konkludojmë se procesi i kahershëm ligjor që është zhvilluar rreth 24 hektarëve tokë të Manastirit të Deçanit më në fund është zgjidhur”, thuhet në njoftim më 20 mars.

Më 13 mars kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi se i kishte kërkuar Agjencisë Kadastrale të transferojë 24 hektarë tokë në emër të Manastirit të Deçanit. Ai tha se zbatimi i vendimit të Kushtetueses do të ishte vendimtar për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës gjatë Asamblesë Parlamentare të këtij institucioni që do të mbahet në prill.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës është kritikuar nga zyrtarët lokalë

në Deçan dhe një shoqatë e historianëve në këtë komunë, që e kanë cilësuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese të padrejtë.

Toka, që u regjistrua në pronësi të Manastirit, gjendet rreth këtij manastiri, në kadastrë kishte qenë e shënuar si pronë e dy ndërmarrjeve “Iliria” dhe “Apiko”, e para hotel dhe e dyta fabrikë mjalti.

Pronësia e Manastirit të Deçanit mbi këta 24 hektarë tokë u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në maj të vitit 2016, por këtë vendim autoritetet lokale të Deçanit nuk e kishin zbatuar, duke argumentuar se kjo sipërfaqe ishte marrë me dhunë në vitet '90 nga regjimi i udhëheqësit të atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq.

Nga Manastiri i Deçanit kishin thënë më herët se në vitin 1997 manastirit iu kthyen 24 nga gjithsej 700 hektarët tokë, të cilët i ishin marrë në vitin 1946 nga pushteti komunist i Jugosllavisë së atëhershme.

Bashkësia ndërkombëtare vazhdimisht i kishte kërkuar Kosovës ta zbatonte vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës



lidhur me 24 hektarët tokë të Manastirit të Deçanit.

Tri partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë komentuar

vendimin e qeverisë Kurti për dhënien e 24 hektarëve tokë Manastirit të Deçanit. Liderët e partive opozitare, Memli Krasniqi, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kanë theksuar se Kurti me kauza të rrejshme erdhi në

pushtet. Sipas tyre, ka qenë vetë kryeministri Kurti që dikur e ka kualifikuar tradhti një vendim të tillë, duke anatemuar e sulmuar secilin protagonist politik të vendit tonë ndër vite, e sot vetë po i zbaton këto vendime.

Osmani i kundërpërgjigjet Hillit: Serbia është larg NATO-s

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka kundërshtuar pohimin e ambasadorit amerikan në Beograd, Christopher Hill, se Serbia është më pranë NATO-s se Kosova.

Pas pjesëmarrjes në një ngjarje të organizuar në Prishtinë në kuadër të “Javës së Gruas”, Osmani tha për mediet se është vetëm një shtet që është më larg NATO-s sesa Serbia, dhe “ajo është Rusia e [presidentit, Vladimir] Putinit”.

Hilli, gjatë një interviste për transmetuesin publik serb, ka thënë më 19 mars se aktualisht Serbia është më pranë aleancës ushtarake perëndimore sesa Kosova, duke thënë se NATO-ja punon çdo ditë me ushtrinë serbe, mban trajnime dhe ushtrime.

Sipas Osmanit, Serbia, sikurse Rusia, shkel vlerat kryesore të



NATO-s, siç është mbrojtja nga forcat autoritare dhe rregullat bazike të së drejtës ndërkombëtare. “Serbia lëre që është larg NATO-s, por as nuk mund të ëndërrojë që një ditë që të jetë pjesë e NATO-s. Serbia vetë është kundër vlerave të NATO-s, nuk ka shprehur ndonjëherë gatishmëri që të anëtarësohet në NATO. Pra është i vetmi shtet i Ballkanit Perëndimor

që vazhdimisht ka deklaruar se nuk do të anëtarësohet në NATO sepse është kundër NATO-s”, ka pohuar Osmani.

Pavarësisht se Serbia nuk ka shprehur aspiratën e tyre për t’u anëtarësuar në NATO dhe fillimisht po kërkojnë që të bëhen pjesë e Programit për Partneritet për Paqe. Partneriteti për Paqe është program i bashkëpunimit praktik dypalësh ndërmjet shteteve partnere euroatlantike dhe NATO-s. Ky program, që është krijuar më 1994, u lejon shteteve të zgjedhin vetë

(EAPC), i cili synon bashkëpunimin politik mes shteteve anëtare të NATO-s dhe shteteve të Partneritetit. “Kushdo që e konsideron Serbinë si shtet që është afër NATO-s, nuk e ofendon vetëm çdo shtet demokratik që po bën hapa konkretë drejt anëtarësimit në NATO por, njëkohësisht, është duke i ofenduar edhe viktimat e Serbisë së [ish-udhëheqësit serb, Slobodan] Millosheviqit, e cila është njëjtë sot, siç ka qenë edhe para disa dekadave”, ka thënë Osmani.

Autoritetet në Kosovë vazhdimisht kanë shprehur aspiratën e tyre për t’u anëtarësuar në NATO dhe fillimisht po kërkojnë që të bëhen pjesë e Programit për Partneritet për Paqe.

Partneriteti për Paqe është program i bashkëpunimit praktik dypalësh ndërmjet shteteve partnere euroatlantike dhe NATO-s. Ky program, që është krijuar më 1994, u lejon shteteve të zgjedhin vetë

prioritetet për bashkëpunim. NATO ka thënë se ky program ka për qëllim ta risë stabilitetin, t’i ulë kërcënimet për paqe dhe të ndërtojë raporte më të forta të sigurisë ndërmjet partnerëve dhe NATO-s. Partneriteti për Paqe përfshin shumë fusha të aktivitetit të NATO-s, sikurse: puna e lidhur me mbrojtjen, forumet e mbrojtjes, trajnimet, stërvitjet ushtarake, planifikimet për përgjigje të emergjencave civile dhe katastrofave të tjera, por edhe bashkëpunimi në shkencë dhe mjedis. Në përgjithësi janë afër 1 600 aktivitete. Pikërisht në kuadër të këtij programi, më 1999 disa shtete dërguan forca paqeruajtëse Kosovë në kuadër të misionit të aleancës në Kosovë, KFOR. Atëbotë ishin vendosur në Kosovë afër 50 000 ushtarë nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30 000 ishin të shteteve të NATO-s. Aktualisht KFOR-i ka mbi 4 700 trupa në Kosovë, përfshirë edhe forcën rezervë.

Tahiri, Hillit: Kërko njohjen e Kosovës nga Serbia

Prishtinë, 20 mars - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka reaguar ndaj deklarimeve të ambasadorit të ShBA-së në Beograd, Christopher Hill, i cili vazhdimisht është duke kërkuar nga Kosova përmbushjen e obligimit për Asociacionin. Ajo ka kërkuar nga diplomati amerikan t’i

kërkojë edhe Serbisë ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Tahiri ka shkruar në “Facebook” se themelimi i Asociacionit shkon vetëm me njohje. “Ambasadori Hill po e shoh se po pohon se Kosova do ta bëjë Asociacionin, por ai duhet të pohojë se Serbia do ta njohë shtetin e Kosovës, sepse është atje ambasador. Asociacioni shkon vetëm me

njohje de jure nga Serbia! Dhe fakti se Serbia do ta njohë Kosovën si kusht për të hyrë në BE, fakt i konfirmuar nga shteti gjerman në kohën kur isha unë kryenegociatore. Mirëpo deri te hyrja e Serbisë në BE shkojnë disa vjet, 7 ose 8 vjet. Prandaj këtë kushtëzim, ‘Asociacion për njohje’, duhet ta zgjidhë BE-ja vetë”, ka shkruar Tahiri.





AMBASADORI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË KOSOVË, JEFF HOVENIER, U ËSHTË PËRGJIGJUR DEKLARATAVE KËRCËNUESE TË PRESIDENTIT SERB ALEKSANDËR VUÇIQ

Kosova ka garanci të forta të sigurisë nga ShBA-ja si kurrë më parë

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, pas takimit që ka pasur të mërkurën me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, ka folur për deklaratat e fundit kërcënuese të presidentit serb Aleksandër Vuçiq, me “pushtimin e mundshëm të Kosovës”. Hovenieri ka theksuar se populli i Kosovës nuk duhet të ndihet i shqetësuar nga këto deklaratat. “Mund të them që përkushtimi ynë për sigurinë e Kosovës, garancitë e sigurisë që ShBA-ja ka ofruar, qëndrojnë të forta si kurrë më parë. Ne flemë rehat sa i përket këtij kërcënimi”, ka thënë Hovenieri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 MARS - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë të mërkurën se qytetarët e Kosovës nuk duhet të shqetësohen për kërcënimet dhe sulmet e mundshme, pasi misioni i NATO-s në Kosovë është “i gatshëm ta bëjë gjënë e duhur”. Gjatë një prononcimi për gazetarë, pas një takimi që ai ka zhvilluar me zëvendëskryeministrin e Kosovës,

Besnik Bislimi, ambasadori Hovenier është pyetur për raportimet se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, ka kërcënuar me “pushtimin e mundshëm të Kosovës”.

Hovenieri ka thënë se garancitë e sigurisë që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Kosovës vazhdojnë të jenë të forta, përderisa tha se Kosova përfiton në aspektin e sigurisë nga prania e misionit të KFOR-it që “është forcë krejtësisht penguese ndaj ndonjë lloji sulmi që qytetarët mund të jenë të shqetësuar”. “Mund të them që

përkushtimi ynë për sigurinë e Kosovës, garancitë e sigurisë që ShBA-ja ka ofruar, qëndrojnë të forta si kurrë më parë. Ne flemë rehat sa i përket këtij kërcënimi. Mendojmë se NATO-ja është e përgatitur dhe e gatshme dhe mendojmë se populli i Kosovës duhet të flegjë rehat sepse aleanca ushtarake më e suksesshme në histori ka një prani të madhe këtu, që është e gatshme të bëjë gjënë e duhur”, ka deklaruar Hovenieri. Ambasadori amerikan u pyet edhe për aspiratat e Kosovës në NATO.

Ai ka theksuar se Uashingtoni mbështet rrugën e Kosovës drejt NATO-s dhe tha se pret që Prishtina një ditë të jetë anëtare e aleancës. Po ashtu, ai foli edhe për deklaratat e ambasadorit amerikan në Serbi, Christopher Hill, i cili ka deklaruar se Serbia është më afër NATO-s sesa Kosova. “Dua të përgënjeshtroj ata që duan të bëjnë krahasime se kush qëndron ku [në raport me NATO-n]”, ka pohuar Hovenier, duke kujtuar se katër shtete të NATO-s ende nuk e njohin Kosovën dhe kjo sfidë, sipas tij, duhet të tejkalohet që të arrihet deri tek anëtarësimi. “Kosova rreshtohet shumë mirë me NATO-n sa iu përket vlerave, institucioneve. Pra, më shumë ka të bëjë me zgjidhjen e këtyre sfidave të tjera dhe të avancojë. Ne presim që Kosova një ditë të jetë anëtare me të drejta të plota e NATO-s”, ka thënë Hovenieri. Diplomati amerikan ka shtuar se

takimi me Bislimin ishte rutinor, pasi një ditë më parë Kosova dhe Serbia zhvilluan një raund të ri bisedimesh. Sa i përket dinarit që, sipas Bashkimit Evropian, palët janë pajtuar që javën e ardhshme t’i paraqesin mendimet e tyre se si të tejkalohen dallimet për të, Hovenieri tha se nuk iu prezantua ndonjë propozim. “Nuk më prezantoi ndonjë propozim specifik. Mendoj se qeveria ende po punon në këtë drejtim. Unë desha t’i shprehja mendimet tona siç kemi bërë vazhdimisht përderisa duam të jemi konstruktivë në këtë proces, por mendojmë se është shumë çështje e rëndësishme që duhet të adresohet”, ka thënë Hovenieri. Ai përsëriti qëndrimin amerikan se duhet të ndryshohet mënyra e zbatimit të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, që parasheh euron si valutën e vetme për pagesa. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi më 1 shkurt.

Negociatat në Bruksel për dinarin, palët pajtohen që të ofrojnë propozime teknike deri më 22 mars

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 MARS - Në Bruksel, një ditë më parë, u mbajtën takimet e radhës në kuadër të procesit të dialogut. I pranishëm aty ishte zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi.

Takimet e zhvilluara ishin bilaterale me BE-në si dhe trilaterale me palën tjetër.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar se çështja qendrore e këtij takimi ishte zbatimi i Marrëveshjes Bazike të Brukselit dhe Aneksit Zbatues të Ohrit.

Mbi këtë, zëvendëskryeministri Bislimi ritheksoi se nënshkrimi i marrëveshjes është garanci për zbatim të plotë të saj konform refuzimit të vazhdueshëm nga Serbia si për nënshkrim, po ashtu për zbatim. "Marrëveshja duhet të zbatohet përmes një plani të sekuençimit të barabartë e të

balancuar mes palëve e që reflekton zbatimin në plotni të saj. U trajtuan mundësitë se si të formalizohet, respektivisht të regjistrohet Marrëveshja Bazike dhe Aneksi i Zbatimit. U kuptua brenga e Kosovës se mosnënshkrimi ka ndikuar në moszbatim të marrëveshjes, por edhe në ashpërsinë e situatave në terren qoftë përmes barrikadave, qoftë me sulme si ai në Banjskë, e që më pas kulmoi me letrën e kryeministres Bërnabiq drejt BE-së dhjetorin e kaluar ku, mes të tjerash, thuhet se Serbia nuk e respekton integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës. Kundrejt kësaj, në takim u riafirmua përsëri refuzimi nga pala serbe mbi marrëveshjen, në zbatim dhe nënshkrim të saj. Në prani të ndërmjetësuesit, kryenegociatori serb e bëri të qartë që për Serbinë nuk do të zbatohen asnjëherë pjesët e marrëveshjes që kanë të bëjnë me njohjen de facto, integritetin territorial apo

anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka thënë Bislimi.

Ai ka treguar se në takim u diskutua edhe mbi tema të tjera të procesit të dialogut si çështja e energjisë dhe mbarëvajtja e zbatimit të saj në terren si dhe kërkesa nga ana e Kosovës për kthimin e artefakteve e për të cilën pala e Kosovës ka dorëzuar dosje drejt BE-së. "U trajtuan edhe një varg shkëlqesh të marrëveshjeve nga ana e Serbisë, përfshirë në fushën e energjisë, telekomunikacionit, interferimit në brezin e frekuencave nga ana e stacioneve televizive serbe, si dhe obstrukcioni i Serbisë në anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Më tej u përmend dhe rregullorja e Bankës Qendrore të Kosovës dhe shqetësimet e fundit rreth saj. Palët u dakorduan që deri në fundjavë të sjellin ide konkrete se si mund të duket një zgjidhje afatshkurtër, gjithnjë duke respektuar vendimin në fjalë të BQK-së. Palët u pajtuan që të ofrojnë propozime teknike

DASH-i kërkon që diskutimet për dinarin të vazhdojnë me urgjencë

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka shprehur mbështetjen për diskutimet që janë zhvilluar së fundmi në Bruksel, të cilat trajtuan çështjen e rregullores së re të Bankës Qendrore të Kosovës. Në një konferencë për medie, zëvendës-zëdhënësi i DASH-it, Vedant Patel, ka theksuar rëndësinë e vazhdimin të këtyre bisedimeve me karakter urgjent. "E mirëpresim takimin e mbajtur në Bruksel brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja, përfshirë diskutime për rregulloren e re të Bankës Qendrore të Kosovës. Besojmë se

këto diskutime duhet të vazhdojnë me urgjencë. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja është kanali adekuat për t'i zgjidhur këto çështje të ndërlydhura me normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë", u shpreh Patel.

Derisa theksoi përsëritjen e thirrjeve të ShBA-së për deeskalimin e tensioneve, Patel tregoi se Shtetet e Bashkuara kanë qenë të qarta për shprehjen e shqetësimeve për rregulloren e re të BQK-së dhe i kanë inkurajuar të dyja palët, Kosovën dhe Serbinë, ta vazhdojnë dialogun.

deri me datë 22 mars, të tilla që pastaj do trajtohen tutje në një takim të ri. Republika e Kosovës e ka bërë të qartë që do ofrojë zgjidhje

teknike sipas planit që ajo ua ka ofruar edhe shteteve të Quint-it javë më parë", ka thënë zëvendëskryeministri Bislimi.



KQZ-ja kërkon buxhet shtesë për blerjen e kamerave vëzhguese në vendvotime

Prishtinë, 20 mars - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere do t'i referohet Ministrisë së Financave, që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i rritet buxheti për vitin 2024 pas kërkesës që ka bërë ky institucion.

Sekretari i KQZ-së, Burim Ahmetaj, ka thënë se në kuadër të transparencës, KQZ-ja ka paraparë të blejë kamera vëzhguese për secilin vendvotim. Për t'u pajisur me këto mjete, ai ka thënë se në total e kalojnë shumën e 1.5 milion euro. "Në kuadër të transparencës KQZ-ja ka paraparë të blejë kamera vëzhguese për secilin vendvotim, që i bien në rreth 2 500 vendvotime për të blerë nga një kamerë, po ashtu edhe pajisje të tjera softuerike të cilat

janë në shërbim të transparencës dhe për këtë janë rreth 1 milion e gjysmë euro të cilat i kemi në buxhet për vitin 2024 dhe të cilat do t'i zhvillojmë gjatë këtij viti. Janë të ndara pjesa kapitale dhe mallra dhe shërbime, sepse disa pjesë janë softuerike, disa janë pajisje që duhen blerë por, sidoqoftë, janë 500 mijë euro për procesin e transparencës, janë edhe 750 mijë euro që do të blihen pajisje harduerike dhe softuerike për transparencë, si dhe një milion euro janë për blerjen e kamerave për secilin vendvotim, që në total e kalojnë 1.5 milion euro vetëm për procesin e transparencës në qendrat komunale të numërimit për gjithë vendin", ka thënë Ahmeti. Në anën tjetër, duke diskutuar



për raportin e vitit 2022, kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se buxheti i përgjithshëm i KQZ-së për vitin 2022 ishte 6 milionë e 24 mijë e 134 euro, ndërsa ka theksuar se prej kësaj shume është shpenzuar 93.2 për qind. "Me

ligjin e buxhetit për vitin 2022 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, KQZ-sa i është akorduar një fond prej mbi 5 milionë e 913 mijë me qëllim të funksionimit të institucionit dhe për t'i përmbushur detyrimet ligjore. Pas shpalljes

së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të katër komunave në pjesën veriore të vendit, si dhe pas vendimit të qeverisë, buxheti i përgjithshëm i KQZ-së për vitin 2022 ishte 6 milion e 24 mijë e 134 euro. Pjesa më e madhe e këtij buxheti, shuma prej 4 milionë e 200 mijë eurosh, i takon kategorisë së subvencioneve dhe transferove. Në përgjithësi buxheti është shpenzuar 93.2 për qind, apo në shumën prej 5 milionë e 617 mijë eurosh. Edhe një raport tjetër e kemi dorëzuar ku e kemi pasqyruar shpenzimin e buxhetit për vitin 2022, me raportin vjetor të punës së KQZ-së, i cili është dërguar në Kuvendin e Kosovës vitin e kaluar", ka thënë Radoniqi.

LETËR E HAPUR KRERËVE TË SHTETIT

Veproni me urgjencë në mbrojtje të republikës!



Dr. Hajdin ABAZI

Ju krerë të shtetit - Kryeministër, Kryekuvendar dhe Presidente, do ta keni dëgjuar atë thënien se *historia nuk e gjykon askënd sipas asaj se çfarë vetë mendon një shtetar, por për veprat e bëra dhe të pabëra* e që kanë mundur të bëhen për të mirë ose në mënyrë parandaluese. Ky ligj i pashkruar i historisë ka vepruar dhe vepron ndaj secilit shtetar, e pra do të veprojë edhe ndaj juve për të mirë e për të keq.

Ju i dini pikëpamjet e mia për juve, më saktë për sjelljet, veprimet e gabimet tuaja që unë i kam konsideruar të tilla dhe shpesh edhe kam shkruar, dhe asgjë nga ato që kam thënë nuk i ndryshoj, jo për shkak të kokëfortësisë, sepse nuk jam aspak i tillë - se nuk ka njeri që i bindet argumentit dhe fakteve më shumë se sa unë, por sepse zhvillimet deri më tash flasin se ato ishin të bazuara. Por për këtë temë ka kohë herë tjetër të shkruaj, se tash po konsideroj se ka diçka më të madhe, shumë më të madhe, dhe për fat të keq edhe shumë më të dëmshme, që është duke u përgatitur që t'i ndodhë Kosovës.

Që kur ishte Escobar këtyre ditëve

(13-14 mars), kam pritur se do të veproni në drejtimin e duhur, por me sa duket nuk e keni kuptuar në thellësi shqetësimin e tij (në fakt, të State Departamentit). Përderisa Presidentja po përpigjet të thotë diçka pa e artikuluar në tërësi e qartësisht, Kryeministri po sillet e deklarohet si edhe më parë thua se nuk di gjë për atë që po i përgatiten Kosovës, kurse Kryekuvendari shkoi edhe më larg - duke etiketuar si në shërbim të Serbisë Lajçak e të tjerë dhe e futi në këtë mes edhe Escobar, që, po qe se zberthehet, domethënë se Bashkimi Evropian dhe SHBA veprojnë me agjenda të Serbisë. Kjo duket tepër e pabesueshme, dhe më tepër ngjanë në teori konspiracioniste. Por, le të hamendësohet, për një çast të vetëm, se qenka ashtu sikurse tha Kryekuvendari. Atëherë, çfarë po bëni ju, si krerë të shtetit, për ta kthyer rrjedhën në favor të Kosovës? Qofsha gabim, dhe lutem njëmend ta kem gabim, por unë nuk po shoh se ka ndonjë veprim në drejtimin e duhur, përkundrazi - shoh veprime në kursin e njëjtë. Escobar për "Evropën e Lirë" (15 mars) deklaroi se nuk arrita ta bind

Kryeministrin Kurti për çështjen e dinarit. Dhe i shtoi kësaj, me një sugjerim jashtëzakonisht të mprehtë dhe paralajmërues, që çështja e dinarit duhet të zgjidhet "para se të bëhet një çështje humanitare", pasi që janë shtresat e gjera të minoritetit si pensionistët, të sëmurët dhe studentët që cenohen - e theksoi Escobar. Krahas kësaj, Serbia ka ofruar shërbime bankare në kufi, për të rritur dramacitetin në sy të botës për gjendjen e rëndë të serbëve në Kosovë dhe se ajo po përpigjet t'u ndihmojë atyre kur askush nuk po e bën!

E pra, duhet të kujtoni se Kushtetuta nuk ju jep vetëm mandat për pushtet, për postet më të larta të shtetit, të Republikës, por ajo ju ngarkon edhe përgjegjësi në mbrojtje nga rreziqet e këtij shteti, të kësaj Republike. A jeni në krye të këtyre përgjegjësisë? Unë e them, aspak me mëri sepse nuk ka mëri që më bën të mendoj në dëm të Kosovës vetëm pse ju jeni në pushtet, pra e them se deri më tash keni bërë të kundërtën. Dhe bëni mirë ta dëgjoni pikëpamjen e një njeriu që mendon e sheh ndryshe nga ju!

Për këtë që sapo thashë, do t'i shtroj, në mënyrë të përmbledhur, argumentet që unë i shquaj, e që, për fat të keq, nuk nënkuptojnë asgjë të mirë.

Nga ardhja juaj në pushtet, si triumfator që për herë të parë në historinë e pasçlirimit të Kosovës, arritët t'i fitoni pak më shumë se 50%, një verdikt që ua dha populli. Kësaj here, nuk ka nevojë t'ua kujtojë premtimet me të cilat ju i përvetësuar zemrat shqiptare, sepse ato ua kanë thënë të tjerët e edhe unë u kam thënë. *A nuk po e shihni se rrjedhat po çoni në drejtimin krejt ndryshe nga ç'po e thoni ju dhe nga ç'është e mirë për Republikën? Andej nga po e bëni të ecë Kosova, nuk është rruga e duhur, jo pa SHBA dhe Perëndimin.*

Por më e keqja është se qasja juaj politike, nga mendësia e pushtetit me mbi 50% të votave dhe mandateve në Kuvend të Republikës, e bënë të pamundur rrëzimin tuaj nga pushteti edhe sikur komplet opozita të bëheshin bashkë - ju bën të ndjeheni tepër të sigurt dhe të pacenuar nga shqiptarët. Dhe kjo është e vërtetë. *Gabimet e juve, si*

krerë të shtetit, kanë të bëjnë me mosdëgjimin e mosveprimin e sipas udhëzimeve të SHBA e të Perëndimit.

Ajo që keni vepruar dhe po vazhdoni të veproni gabim, në gjykimin tim, shtrihen në dy drejtime: të jashtme dhe të brendshme.

Veprimet në politikën e jashtme duke filluar nga qëndrimi prolonguese ndaj gazit natyror që ishte projekt amerikan e deri te mosdëgjimi i hapur e publik ndaj sugjerimeve të SHBA, ju i keni çuar në degradim të vazhdueshëm raportet e Kosovës, në radhë të parë, me partnerin tonë kryesor - SHBA, e pastaj edhe me BE dhe edhe me NATO-n, e madje edhe me vendet fqinje. (Nëse keni ditur ta lexoni dhe ta kuptoni, këtë e tha me dëshpërim emisari i SHBA Escobar). Dhe problem i dorës së parë që ngjallte brengë ishte çështja e sigurisë, për çka SHBA-BE-NATO po bëjnë çmos për ta parandaluar një konflikt të armatosur në Ballkanin Perëndimor për çka ka nxitje nga Rusia, dhe ku ishin pritjet që Kosova të luante rolin e

saj, të ishte në shërbim të kësaj strategjie.

Veprimet e brendshme, këtu do të fokusohem vetëm në ato që lidhen me minoritetin serb, janë karakterizuar me gabime krejt irracionale e që i kanë rënë, dhe ka rrezik edhe më t'i bien, në kurriz Kosovës. Dikur ju thoshit se do të dialogoni me serbët lokalë - këtë nuk e bëtet. Askush para jush nuk ia ka arritur kësaj, e as ju, për shkak të interferimit të Serbisë në krye të së cilës është kryeshovinisti Vuçiq. Qasja juaj, për dallim nga qasja politike e mëhershme që ishte e ngadalshme por e kujdesshme në raport me minoritetin serb, u bë gjithnjë me veprime të befashme, ani se në parim gjithnjë ishin çështje të drejta. Edhe pse të tilla, kur ato procedohen me mungesë taktike, japin frute të hidhura, domethënë rezultate të kundërta. A nuk e kuptonit vallë se veprimet ndaj minoritetit serb, janë çështje tepër sensitive, pikërisht sepse janë çështje të minoritetit dhe se duhet vepruar me maturi, përgatitje të shumta e konsultime të ngjeshura paraprake me SHBA? Krahas kësaj, veprimet ndaj minoritetit serb kishin të bënin me çështjen tjetër të ndjeshme - atë të sigurisë, pasi që Evropa ndodhet në një kohë luftë të Rusisë ndaj Ukrainës dhe të rrezikut të përhapjes edhe nga Serbia ndaj Kosovës, Malit të Zi e të Maqedonisë së Veriut pa harruar Bosnjë-Hercegovinën? A nuk mësuar se veprimet e njëanshme (në kuptimin pa bashkërendim paraprak me SHBA? Serbia i shfrytëzon mjeshhtërisht për të shtrembëruar të vërtetën në sy të botës Perëndimore? Ajo u nxit në veprim terrorist dhe agresioni për çka Escobar tha se Serbisë nuk i kërkojnë hetime, po llogaridhënie. Beogradi nuk do të veprojë më njëllëj - dhe po e shohim se po i mban nën kontroll minoritarët serbë duke mos i nxitë për veprime të dhunshme. Tash ka strategji e taktika të tjera, për të cilat do të flas në vazhdim.

Duke filluar nga çështja e stikersave, e tabelave të veturave e deri tash të çështja e dinarit, ishin veprime, gjithsesi në frymë të Kushtetutës, por me takt të gabuar politik, dhe në shumicën e rasteve pa konsultime dhe bashkërendim paraprak me SHBA sidomos, por edhe me NATO (KFOR-in) dhe BE-në. Këto i kanë theksuar këto vende, dhe po këto i tha në takimin e këtyre ditëve emisari Escobar në Prishtinë. Madje, ndërkohë sa ai ishte në vizitë në Kosovë e rajon, u ndërmor veprimi për ndryshimin e tabelave të rrugëve në vendbanimet serbe, gjë që e bëri të reagojë edhe Escobar e edhe komisioneri evropian për minoritetet!

Duke u bërë pa konsultime paraprake me SHBA, këto veprime ndaj minoritetit serb po perceptohen si të qëllimshme dhe të dëmshme për të. SHBA u

mundua të ushtronte ndikimin e vet duke ju futur në një kurs që do ta mbronte Kosovën në mënyrë afatgjate, por ju u treguat vazhdimisht refuzues, dhe këtë e bëtet ne emër të sovranitetit! Por sovraniteti nuk mund të ruhet vetëm duke u thirr në një Kushtetutë, sidomos jo në kushtet e një rreziku të jashtëm për luftë dhe që mund të shfrytëzohej, ashtu sikurse u shfrytëzua e po shfrytëzohet shumë, nga gjeopolitika ruso-serbe. Madje, sikur të mos ishte NATO (KFOR-i) në Kosovë, sovraniteti rrezik të kthehej në të kundërtën e vet - dhe duket se ju keni llogaritur në praninë e NATO-s dhe pamundësinë e Serbisë. Serbia, veprimi më 24 shtator me tentim-agresioni, gabim të cilin ju nuk ditët ta kapitalizoni aspak dhe ta bëni kthesën për bashkërendim me SHBA!

Nga sa i gjykoj unë rrethanat, Serbia ka mësuar nga gabimet e veta dhe nuk do t'i përsëris më ato. Shovinizmi serb është aq dinak, por edhe i zhdërvjellët sa të bëj veprime tepër të sofistikuar që të tërheqin vëmendjen e botës në favor të tyre dhe në të keq të Kosovës, e kjo në një rrethanë kur SHBA, BE dhe NATO, e do të mjaftonte të thuhet vetëm SHBA, janë në raportet të ftohura ndaj Kosovës, gjë që praqet një klimë të pafavorshme për Kosovën dhe të favorshme për Serbinë!

Rrethanat ndërkombëtare janë të pafavorshme për Kosovën, jo vetëm nga vendet që janë armike dhe nga ato vende që nuk na kanë njohur për arsyet e tyre, por, çka është edhe më e keqja, edhe nga vendet perëndimore që kanë qenë sponsorizues të Pavarësisë sonë. Edhe më parë, gjithsesi, kishte ndonjë veprim të gabuar e që binte ndesh - por shpejt korrektohej e rikthehej gjendja pa u bërë e madhe dhe publike, vetëm se nga ardhja e juaj më 2021 në pushtet më shumë jeni acaruar më vendet mike e sponsorizuesit e Pavarësisë se sa jeni koordinuar me ta, gjë që, si rrjedhojë, ka ardhur deri të veprimi absurd: Kosovës t'i vihen sanksione! Të gjitha gjasat ishin që Serbisë t'i viheshin sanksione, dhe do të duhej t'i viheshin asaj, por nga veprimet jashtë sugjerimeve dhe kërkesave të SHBA, BE e të NATO - gishtit iu drejtua Kosovës, dhe iu vendosën sanksionet. Ndoshta menduat të arrinit diçka të mirë, por ju doli keq. Dhe e kam thënë disa herë e po e përsëris: **asgjë e mirë nuk i vjen Kosovës kur nuk bashkërendohet me SHBA**, e sidomos kur veprohet në të kundërtën e udhëzimeve që vijnë nga SHBA!

Ku është rreziku që është aktual dhe që po i kanoset aktualisht Kosovës? Deputeti dhe veprimtari shumëdekadësh i lëvizjes kombëtare Xhavit Haliti tha se ka informacione se po përgatitet që pas zgjedhjeve lokale në veri të shpallet Asociacioni. Mbase nga gjendja në terren kjo mund të dihet, por unë në të njëjtin

përfundim kam arritur duke e analizuar deklaratën e Vuçiqit. Vuçiqi tha shumë, e në të njëjtën kohë u mundua ta maskojë mesazhin e vet. Por nga një lexim i vëmendshëm, mund të nxirret kuptimi dhe çfarë ai tha. "Nuk është problem, doni të jeni me ata, nuk do të na keni neve, doni të jeni me ta dhe t'u ndihmoni atyre, do të mbijetojmë, por jemi mjaft të mësuar dhe shumë përvoja kemi fituar pas gjithë atyre që na keni bërë në 25 vitet e fundit, për ta pritur momentin më të mirë të mundshëm dhe të luftojmë për rastin tonë. (...) Nuk kemi pse t'ia fshehim askujt. Do të jemi gjithmonë të hapur për partneritet, bisedime, dialog, por duhet ta kuptoni mirë - i keni bërë shumë të këqija popullit serb të gjithë ju së bashku" (...) Pastaj, lansoi gënjeshtërën: "Banjska ndodhi sepse po i vrisnin njerëzit tanë në Kosovë" (Gazeta Express, 19.03.2024, ora: 14:13).

Ndaj kësaj deklarate reagoi emisari Escobar nga Mali i Zi, duke thënë se vetëm një shtet (Serbia) po bën kërcënime në drejtim të Kosovës, duke e konsideruar si "ndikim malinj rus".

Përgjithësisht, duket se është kapur vetëm theksi kryesor i deklaratës së Vuçiqit, se "jemi duke pritur rastin më të mirë të mundshëm dhe të luftojmë për rastin tonë". Kjo edhe është e vërtetë, porse edhe shumë çka tjetër ekspozon, në mënyrë të kamufluar, deklarata e tij.

Çka në të vërtetë, tha Vuçiq, mund të kuptohet po qe se dekonstruktiohet shprehja metaforike dhe e kamufluar si dhe aspekti propagandistik. Nga një lexim i vëmendshëm, shquhen këto mesazhe:

1) jemi mjaft të mësuar dhe shumë përvoja kemi fituar pas gjithë atyre që na keni bërë në 25 vitet e fundit,
2) jemi duke pritë momentin më të mirë të mundshëm dhe të luftojmë për rastin tonë,
3) do të jemi gjithmonë të hapur për partneritet, bisedime, dialog,
4) e keni bërë shumë të këqija popullit serb të gjithë ju së bashku.

Këto janë të ndërlidhura, kanë kohezion dhe ngërthejnë një strategji dhe taktika paralajmëruese. Mesazhi i parë ndërtohet mbi akuza (gjithë atyre që na keni bërë në 25 vitet e fundit), që ua rikujton ato që Perëndimi "ua ka bërë serbëve". Nuk thotë se e ndëshkuat politikën shoviniste, por popullin serb, për ta bërë akuza më e fuqishme ndaj Perëndimit. Ani se dihet që Perëndimi veprimi për ta ndëshkuar politikën gjenocidale dhe të dëbimit biblik dhe shfarosës të Milosheviçit ndaj shqiptarëve të Kosovës. Por ky është vetëm preteksti, nuk është thelbi (ani se në një kontekst, ai kthehet në thelb më pas). Pastaj vjen mesazhi kryesor: **jemi mjaft të mësuar dhe shumë përvoja kemi**

fituar! Për çfarë është e mësuar Serbia nën udhëheqjen shoviniste? Çfarë përvoje kanë grumbulluar? Sigurisht, që kjo ngërthen shumëçka, por unë mendoj se themelore është kjo: **kemi mësuar nga ju dhe kemi marrë përvojë nga ju, që të veprojmë si ju!**

Dhe kjo lidhet me mesazhin e dytë: **për ta pritë momentin më të mirë të mundshëm dhe të luftojmë për rastin tonë.** Pra, qartazi, nuk do të bëhen veprime të ngutshme por do ta presin (mund të lexohet edhe: do ta krijojmë) momentin më të mirë të mundshëm. Për çfarë? Të luftojmë për rastin e tyre.

Edhe kjo ka shumë kuptime, por unë e zbërthej kështu: për serbët e Kosovës (qoftë si pretekst, si veprim konkret, e nëse zhvillimet shkojnë në drejtimin e strategjisë ruse: edhe të një luftë të vërtetë). Fjala luftë, duhet kuptuar, pra në dy dimensionet: si **luftë me mjete politike**, por, në një rast të volitshëm, **edhe si luftë ushtarake.**

Se nuk është në radhë të parë lufta ushtarake që po përgatitet Serbia, e tregon mesazhi i tretë: Do të jemi gjithmonë të hapur për partneritet, bisedime, dialog. Kjo domethënë, se pas veprimit të parë, do të jenë të gatshëm për dialog. Një dialog, për ta çuar përpara agjendën shoviniste në kontekstin e minoritetit serb.

Dhe mesazhi i fundit, sërish ia kujton Perëndimit se: i keni bërë shumë të këqija popullit serb të gjithë ju së bashku! Pra, komplet Perëndimi!

Nëse sado pak kam të drejtë në këtë dekonstruktiv të mesazheve shumëkuptimshme që i përçoi Vuçiq, unë shquaj një skenar pak a shumë të këllillë (unë e shoh edhe më të rrezikshëm në detaje, por po përmbahem vetëm të aspekti më të përgjithshëm):

Politika shoviniste në krye me Vuçiq, pasi sheh se politikisht Kosova është acaruar edhe me vendet që e kanë sponsorizuar pavarësinë dhe shtetbërjen dhe imazhi i Kosovës te Perëndimi ka rënë në pikën më të ulët deri më tash, e sheh si momentum që të veprojë. Te veprojë, por më mësimet dhe përvojën e arritur. Domethënë: serbët e Kosovës do të organizohen, pas zgjedhjeve lokale, që priten të shpallen së shpejti, dhe pasi të njihet zyrtarisht rezultati i tyre e pastaj do ta shpallin (të paktën) Asociacionin. Pushtetarët e rinj komunalë do të kenë legjitimitetin e votës qytetare, dhe do të jetë një akt, në përputhje me ato që po kërkojnë vendet e Perëndimit nga Kosova. Analogjia është e qartë. Njëanshëm e shpallin Asociacionin serbët. Meqë ju Perëndimi nuk arritët as pas 11 vitesh t'i bindin shqiptarët për Asociacion, do të thonë ata, të zgjedhurit e shpallën atë. Tash, si i keni përkrahur shqiptarët, përkrahni edhe serbët!

Kështu Perëndimi do të përballet me vlerat dhe qëndrimet e veta. Ashtu sikurse është krijuar klima nga veprimet e pakoordinuara të

Qeverisë së Kosovës me SHBA e BE e me NATO, e tha ambasadori amerikan Hovenier dhe emisari Escobar se ndalimi i dinarit po merr konotacion humanitar - gjë që Serbia po e shfrytëzon dinakërisht.

Po ndalem me kaq, ani se, kushdo që ka ndjekur konvergimet e gjeopolitikës serbe me atë ruse, e ka të qartë që Beogradi ka strategji për përshkallëzim të mëtejshëm, me pasoja tepër të rrezikshme për shtetin e Kosovës dhe mbase edhe më gjerë, dhe këtë edhe e theksojnë emisarët e SHBA, Britanisë së Madhe e të Gjermanisë.

Mendoj se nga kjo, sa e kuptova dhe si e kuptova unë nga zbërthimi i asaj që deklaroi Vuçiq, rrjedhë një apel që duhet drejtuar krerëve të shtetit, ndaj dhe e titullova si letër të hapur këtë shkrim.

Paraprakisht dua t'ua kujtoj atë thënien e mirënjohur për veprimin politik se **dje ishte herët, nesër është vonë, sot - pikërisht sot duhet vepruar.** Kjo thënie i shkon situatës së krijuar dhe rreziqeve para të cilave ndodhet Kosova, kryesisht nga strategjia ruso-serbe, por edhe nga veprimet tuaja në kundërshtim me sugjerimet amerikane që ishte dhe është gabimi më i madh i mundshëm politik.

Në konceptin tim, ardhja në pushtet me mbi 50% të votave, do të duhej t'u bënte juve të shihni përtej kufijve të ngushtë ideologjik dhe përtej posteve tuaja e përtej pushtetit tuaj. Nuk po e shoh këtë ta bëni, prandaj po ju drejtohem me këtë apel:

- Kryeministër Kurti, rreziku po dihet dhe skenari analog po shihet. Posti i kryeekzekutivit të Republikës të ngarkon me bërë çmos për të shmang një të keqe të tillë! Nuk të arsyeton fakti se shovinistët po veprojnë, pasi që shtrohet pyetja ti çka po bën për ta parandaluar dhe për ta çuar rrjedhën në kahen e kundërt, pra në të mirë të Kosovës! Ti je Kryeministër i vendit, dhe i ke mbi 30 këshilltarë dhe duhet të dish se ç'hapa të bësh për mos të lejuar dëmtimin e Republikës!

- Kryekuvendar Konjufca, në vend që të zbulosh armiq, do të ishte mirë të dalësh me opsione veprimi me shpejtësi, për t'i dhënë kahun rrjedhave në të mirë të Kosovës, që të evitohet rreziku që po i kanoset Republikës!

- Presidente Osmani, ti bile, si pro SHBA, a po i sheh kahet e zhvillimeve? Nuk mjaftojnë vetëm fjalët, tash duhen edhe veprime, madje tepër të prera. Çdo gjë që mund të dëmtohet Republika nën mandatin tënd, të adresohet edhe ty po aq. Duhet të dish të veprosh për të ndaluar një të keqe që po vjen si uragan!

Kushtetuta ju obligon te veproni në mënyrë parandaluese dhe të mbronit Republikën!

Ruajtja e Republikës është çështje kombëtare!

Duhet të veproni shpejt, sepse historia nuk do t'ua falë!

Dështon mbledhja e komisionit hetimor për rezerva, shkak mungesa e kuorumit

PRISHTINË, 20 MARS - Për shkak të mungesës së kuorumit ka dështuar mbledhja e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin e rezervave shtetërore. Në pikë të rendit të ditës ishte diskutimi rreth kërkesave për sjellje të dokumentacionit. Të pranishëm ishin Driton Hyseni, Halil Thaçi, Salih Zyba të Lëvizjes Vetëvendosje dhe

Valentina Bunjaku-Rexhepi e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Deputeti i LV-së, Driton Hyseni, pati kritika për mungesë të opozitës. Tha se në mbledhjen e mëhershme janë marrë vendime pa u konsultuar mazhoranca. "Nuk kemi kushte për fillimin e punës së këtij takimi, mirëpo e konsideroj të papranueshme thirrjen e mbledhjes së komisionit hetimor dhe mosgatishmërinë

e opozitës për të marrë pjesë në këtë mbledhje. Gjithsesi, do të dëshironim të trajtonim disa çështje që kanë rrjedhur nga mbledhja e fundit e komisionit hetimor, çështjet të cilat nuk kanë filluar mirë vendimmarrjen në këtë komision. Nga kolegët e opozitës janë marrë hapa në mënyrë të njëanshme duke dërguar shkresa pa ndonjë vendimmarrje të komisionit hetimor", ka thënë Hyseni.



Kosova dhe Gjermania nënshkruajnë deklaratën e partneritetit për klimën dhe energjinë

BERLIN, 20 MARS - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe ministria gjermane e Shtetit, Anne Luhrmann, kanë nënshkruar deklaratën e përbashkët të synimit për krijimin e një partneriteti dypalësh për klimën dhe tranzicionin energjetik. Kjo marrëveshje ka për qëllim ta thellojë bashkëpunimin mes dy shteteve tona për çështjet e mjedisit dhe energjisë dhe fokusohet në: Planifikimin e politikave net zero dhe zbatimin e ligjit të Kosovës për ndryshime klimatike; Tranzicionin e shpejtë dhe të drejtë të energjisë; Pjesëmarrjen e Kosovës në

proceset ndërkombëtare klimatike si UNFCCC dhe COP; Ngritjen e ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike - deklarata është nënshkruar në Berlin gjatë Konferencës "Dialogu i Tranzicionit të Energjisë në Berlin 2024 (BETD)". Sipas deklaratës, Kosova dhe Gjermania rikonfirmojnë përkushtimin e fuqishëm për ta avancuar zbatimin e Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), marrëveshjen e Parisit dhe vendimet e marra nga konferencat përkatëse të palëve (COP), si dhe Deklaratën e Sofjes mbi Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor,



objektivat e energjisë dhe klimës për 2030, miratuar nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë dhe Deklaratën e Përbashkët të Synimit ndërmjet Liderëve të Gjashtës së Ballkanit Perëndimor dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Partneritetin Rajonal të Klimës ("Deklarata e Përbashkët Rajonale"), miratuar në Samitin e Procesit të Berlinit në Tiranë në tetor 2023.

Në deklaratë janë të parapara objektivat, çështjet që mbulon partneriteti, krijimi i dialogut dhe format e bashkëpunimit, zbatimi dhe drejtimi i partneritetit, burimet dhe dispozitat përfundimtare të deklaratës.

UNDP-ja certifikon trajnerët për instalimin e paneleve solare



PRISHTINË, 20 MARS - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka organizuar një ceremoni certifikimi, duke festuar arritjet e trajnerëve të ardhshëm për instalimin e paneleve solare. Kjo ngjarje, e mbajtur në Qendrën e Aftësisit Profesional në Ferizaj, ka shënuar përfundimin e trajnimit rigoroz, të dizajnuar për t'i pajisur pjesëmarrësit me teknikat më të reja të instalimit solar, duke siguruar që ata të mund ta përcjellin këtë ekspertizë te gjenerata e ardhshme e profesionistëve, në Qendrat e

ndryshme të Aftësisit Profesional (QAP). Në prani të ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, përfaqësuesit të përhershëm të UNDP-së, Nuno Queiros, dhe drejtoreshës ekzekutive të Agjencisë së Punësimit, Jehona Namani-Rexha, pesë trajnerëve nga QAP në Ferizaj, Mitrovica, Prizreni, Gjakova dhe Prishtina u janë dorëzuar certifikatat. Përkushtimi, puna e palodhur dhe gatishmëria e tyre për të kontribuar në industrinë e energjisë solare, duke arsimuar

gjeneratat e ardhshme të instaluesve të paneleve solare, u mirëpritën nga të gjithë.

Aktiviteti, që u përqendrua në trajnimin e instaluesve të paneleve solare dhe kishte për synim mbështetjen e integritetit të modulit për instalim solar në Qendrat e Trajnimit Profesional, ishte projektuar për ta promovuar rimëkëmbjen e gjelbër, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe tranzicionin e energjisë, dhe u mbështet nga Projekti Premtimi Klimatik i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga UNDP-ja në Kosovë.

Murati takon ambasadorin e ri të Britanisë, flasin për bashkëpunimin ekonomik

Prishtinë, 20 mars - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, duke i uruar mirëseardhje dhe përgëzuar për misionin e ri diplomatik. Gjatë takimit ministri Murati ka paraqitur disa nga prioritetet qeverisëse dhe masat e ndërmarra nga MFPT-ja për realizimin e këtyre

objektivave. Ndër të tjera, u përmendën masat për punësimin e të rinjve, të grave dhe grupeve të cenueshme të shoqërisë, si dhe politikat për luftimin e ekonomisë joformale dhe korrupsionit. Ambasadori Hargreaves e përgëzoi ministrin për punën e bërë deri më tani, veçanërisht për arritjen e stabilitetit fiskal dhe menaxhimin e financave publike. Diskutimi vazhdoi me

shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim ekonomik, përfshirë investimet në infrastrukturë dhe organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Të dyja palët theksuan marrëdhëniet e shkëlqyeshme të Kosovës me Mbretërinë e Bashkuar duke potencuar vullnetin dhe gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në të ardhmen.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (7)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-15- Konfidenciale

Rt. Hon Lord Carrington KCMG MC
Ambasada britanike
Beograd
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
Londër SW1, 24 prill 1981
Shkëlqesia Juaj,
Kosova

1. Demonstratat dhe trazirat e kohëve të fundit në Kosovë, krahinë jugore e Serbisë, kanë theksuar përsëri problemet me sa duket të pazgjidhshme të kësaj pjesë të shtetit multinacional jugosllav. Në telegramin tim Nr. 45, të datës 7 prill, kam bërë një vlerësim fillestar të ngjarjeve. Në këtë dokument ju ofroj, mbi bazën e informacioneve që kam aktualisht në dispozicion, një përshkrim më të studiuar të asaj se çfarë ka ndodhur, pse dhe çfarë pasojash mund të ketë.

Ngjarjet

2. Demonstratat filluan rreth orës 7 pm më 11 mars pas disa ditë ankesash nga studentët e Universitetit të Prishtinës në lidhje me marrëveshjet e bëra për furnizimin e tyre me ushqime. Një student flaku tej me neveri një tabaka me ushqim, por kjo nuk e ndezi dhunën që pasoi. Dhuna u shkaktua me sa duket nga një grup prej rreth 30 studentësh, të cilët shpërthyer nëpër mensë, duke bërë turrë dhe duke hedhur karrige dhe tryeza nga dritarja dhe në banakun e sportelit. Më pas studentët dolën në rrugë, duke formuar një turmë prej 400 vetash, dhe u drejtuan për në qendër të qytetit ku u përplasën me milicinë, duke plagosur rreth dhjetë prej tyre. Përfundimisht forcat e milicisë arritën që t'i kthenin mbrapsht studentët në konviktet e tyre, por një pjesë qëndruan jashtë deri rreth orës 2 am duke thirrur parulla politike. Të nesërmen, rektori dhe disa nga pedagogët e stafit u takuan me studentët dhe diskutuan mbi mënyrat për përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës dhe studimit. Dukej më pas sikur kjo trazirë kishte marrë fund, megjithëse një zjarr misterioz në Patriarkanën Ortodokse Serbe në Pejë, gjatë orëve të para të mëngjesit të datës 16 mars, mund të ketë qenë vepër e nacionalistëve shqiptarë, me gjithë mohimet zyrtare, të cilat mbështeteshin me

entuziazëm nga Kisha.

3. Megjithatë, më 26 mars një grup prej rreth 40 studentësh u hodhën përsëri në veprim rreth orës 6 am duke mbyllur dyert e tre konvikteve të studentëve, kështu që studentët e tjerë nuk mund të dilnin jashtë. Më pas ata i bindën këta të fundit që të bashkoheshin në territorin e Universitetit, ku formuan një turmë prej disa qindra vetash, e cila shpejt u takua me rektorin dhe disa prej stafit të pedagogëve. Udhëheqësit e studentëve filluan të negocionin me rektorin për të drejtat e tyre por ai i ndërpreu kur ata filluan të paraqisnin kërkesa politike. Demonstratat politike duket se kanë filluar në këtë pikë, kur demonstruesit nxorën flamujt e bërë gati dhe thirrën më zë të lartë parulla politike. Rreth orës 4 pm ata filluan të gjuanin me gurë milicinë, duke krijuar një kordon rreth tyre, në përpykje për t'u larguar nga kampusi dhe për të dalë në qytet, ku rreth 40,000 veta ishin mbledhur për të përshëndetur mbërritjen e stafit përfaqësues të Titos në udhëtimin e tij përmes Kosovës me rastin e stafetës së përvitshme të rinisë përreth Jugosllavisë. Milicia u përgjigj fuqimisht, disa thonë brutalisht, dhe 23 demonstrues u plagosën, 22 veta nga udhëheqësit e tyre u arrestuan, ndërkohe që gjithashtu u plagosën 14 milicë. Gjatë ditëve në vazhdim, pati akte të tjera dhune, si p.sh. thyerja e xhamave të dritareve dhe prishja e makinave, veçanërisht në komunat përreth Prishtinës, por edhe deri në Prizren.

4. Trazirat rifilluan më 1 prill në Prishtinë me bojkotin e mësimit nga disa studentë dhe nxënës të shkollave të mesme. Rreth orës 1 pm tre grupe demonstruesish u zhvendosën drejt qendrës së qytetit, duke grumbulluar gjatë rrugës fëmijë shkollash dhe disa punëtorë. Sipas një dëshmitari okular britanik, dhuna filloi kur me turmën u bashkuan punëtorët dhe kur demonstruesit u tërbuan duke thyer xhamat e dritareve dhe duke i vënë flakën makinave dhe një shtëpie ndërkohe që marshonin drejt ndërtesës së Komitetit Krahinor. Grupet, secili i përbërë prej 6-800 vetash, u grumbulluan rreth orës 3 pm përpara ndërtesës, ku valëvitnin flamujt dhe thirrmin me zë të lartë parulla, të cilat qarkullonin më shirita letre, të tilla si: "Kosova Republikë"; "Jemi

shqiptarë, jo jugosllavë"; "Nuk e duam kapitalizmin, duam socializmin"; "Poshtë revizionizmi" dhe "Duam Shqipërinë e bashkuar". Rreth orës 6.30 pm dy nga demonstruesit i afruan milicisë tek dyert dhe thanë se po prisnin që të fillonin negociata me dikë. Por, turma më pas filloi të shtynte përpara dhe milicia reagoi duke hedhur bomba me tym dhe gaz lotsjellës për të shpërndarë demonstruesit. Këta të fundit duket se ishin të përgatitur për këtë: ata kishin peshqirë të lagur të gatshëm për të reduktuar efektet e gazit lotsjellës dhe vazhduan të grumbullohen sërisht a thua se, siç thanë disa, po drejtoheshin me radio marrëdhëse-dhënëse. Në asnjë fazë forcat e milicisë nuk hapën zjarr në Prishtinë megjithëse dy demonstrues u gjetën të goditur për vdekje, por ata u detyruan t'i përgjigjeshin zjarrit në vende të tjera. Njësitë e Forcave të Armatosura u zhvendosën më pas në Prishtinë nga pjesë të ndryshme të vendit për të siguruar pikat strategjike në këtë qytet dhe gjetkë në zonat përreth, ku raportohej për demonstrata më 2 prill dhe, në mënyrë sporadike, gjatë dy ditëve në vazhdim.

5. Që atëherë, nuk janë raportuar shqetësime të tjera. Ndalimqarkullimi i vendosur më 2 prill u hoq më 8 prill, por masa të tjera kufizuese kanë mbetur në fuqi, duke përfshirë ndalimin e tubimeve jozyrtare publike, e madje edhe ndeshjet e futbollit, kontrollet e rrepta fizike për të gjithë udhëtarët në këtë zonë dhe ndalimin e vizitave nga të huaj. Pas mbylljes së shkollave fillore për një periudhë dy javore, ato u hapën përsëri më 13 prill, dhe një javë pas tyre u hapën shkollat e mesme dhe universiteti.

6. Duke folur para një grupi të ftuar gazetarësh të huaj në Prishtinë, më 17 prill, kryetari i Komitetit Krahinor të Kosovës, pranoi se të gjithë organizatorët dhe mbështetësit i përkisnin komunitetit shqiptar, se punëtorët dhe studentët ishin nga ky komunitet, dhe se ata përfshinin gjithashtu disa anëtarë të Lidhjes së Komunistëve. Ai dha statistika të shqyrtuara për të treguar se vetëm 75 civilë ishin dëmtuar dhe 8 ishin vrarë, ndërsa 131 anëtarë të forcave të sigurisë ishin dëmtuar, katër prej tyre rëndë dhe një ishte vrarë, të gjithë shqiptarë. Ndërkaq, 29 njerëz ishin burgosur nën akuzën e të qenit organizatorë të demonstratave, ndërsa 194 njerëz ishin dënuar se kishin marrë pjesë në demonstrata dhe veprime të tjera armiqësore.

Shkaqet

7. Të gjitha të dhënat tregojnë se demonstratat ishin organizuar dhe drejtuar me qëllim nga shqiptarë të motivuar politikisht, kryesisht studentë. Parullat dhe banderolat ishin qartazi të natyrës irredentiste dhe nacionaliste shqiptare. Mund të kenë qenë të përfshirë edhe elementë të tjerë të spektrit të majtë dhe të djathtë politik, siç pretendonin zëdhënës të ndryshëm zyrtarë, por shkakun

kryesor duhet ta kërkojmë tek nacionalizmi shqiptar. Në të vërtetë, një anëtar drejtues i Komitetit Qendror i Sllovenisë tha kohët e fundit në lidhje me Kosovën se "shkaqet kryesore të të gjithë krizave të rënda të Jugosllavisë deri më sot duhet të gjenden tek nacionalizmi dhe jo aq shumë tek problemet sociale".

8. Kosova ka dalë në shpërthime të dhunshme të nacionalizmit në disa raste që prej Luftës së Dytë Botërore. Që nga fillimi, Kosovarët ngurronin të bashkoheshin me Jugosllavinë dhe një kryengritje e viteve 1944-1945 u shtyp pa mëshirë, megjithëse pas kësaj vazhdoi për njëfarë kohe një rezistencë në shkallë të kufizuar. Në vitin 1955, u shpall gjendja e jashtëzakonshme për të shuar trazirat që me sa duket ishin nxitur prej terroristëve nga Shqipëria. Rankovic dhe policia e tij sekrete e dominuar nga serbët (UDBA) u shoqëruan veçanërisht me shtypjen brutale të shumicës shqiptare në Kosovë. Pas rrëzimit të tij në vitin 1966 dhe ndryshimeve në UDBA, shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoni u ndjenë të inkurajuar në qershor 1967 që të kërkonin Republikë më vite brenda Federatës dhe organizuan demonstrata në shkallë të gjerë në nëntor 1968, të cilat u shtypën përfundimisht nga Forcat e Armatosura. Megjithatë, trazirat nacionaliste vazhduan gjatë gjithë viteve '70: anëtarët e "Lëvizjes Kombëtare Shqiptare" u burgosën në vitin 1975; 31 studentë u burgosën në vitin 1976 si anëtarë të Lëvizjes; arrestime të tjera vijuan në vitin 1979 dhe vetë Tito vizitoi Kosovën për të qetësuar situatën; dhe në vitin 1980, tetë nga personat e arrestuar më parë u dënuan me tre deri në tetë vite burgim. Kërkesat e nacionalistëve të Kosovës luhaten midis bashkimit me Shqipërinë dhe pavarësisë nga Serbia si Republikë brenda Jugosllavisë, megjithëse kjo e fundit mund të jetë gjithashtu vetëm një fazë drejt së parës. Përmes shpërthimeve dhe ndryshimeve të mëvonshme në statusin kushtetues të Krahinës, Kosova ka lëvizur një hap më afër vetëvendosjes në Jugosllavi, por është e qartë se nacionalistët nuk janë ende të kënaqur me tutelën formale të Serbisë, megjithëse ata kanë fituar barazinë pothuaj në çdo drejtim tjetër me Republikat e Jugosllavisë.

9. Ngjarjet kanë edhe një dimension ndërkombëtar. Unë nuk kam asnjë provë për përfshirjen e sovjetikëve dhe Gëriçkov, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve, e përjashtoi hapur këtë, në një bisedë me mua, më 6 prill. Përfshirja e Shqipërisë, megjithëse është mohuar zyrtarisht në Tiranë dhe nuk është pranuar haptazi në Beograd, është e mundur. Natyrisht tundimi për bashkim mund të jetë i fortë, kur përtej kufirit jeton një popullsi shqiptare etnike që është sa gjysma e vetë popullsisë në Shqipëri. Dhe Tirana e bëri të qartë në një artikull të shprehur me forcë në gazetën

"Zëri i Popullit" më 8 prill, gjë që e vuri Jugosllavinë në siklet, se Shqipëria kishte po aq të drejtë sa Jugosllavia apo ndonjë vend tjetër që të mbronte pakicat e veta kombëtare. Për më tepër, ambasadori shqiptar këtu nuk mban të fshehtë pakënaqësinë e vendit të tij në lidhje me kufijtë aktualë me Jugosllavinë. Por, siç kanë theksuar udhëheqës të ndryshëm jugosllavë në ripërtëritjen e shkëmbimeve kritike me Tiranën, stabiliteti në Kosovë është në interes të Shqipërisë po aq sa edhe të Jugosllavisë. Ata mund të kenë shtuar se kjo zbatohet veçanërisht kur Enver Hoxha po i afrohej fundit të mbretërimit të tij, dhe mund të zhvillohej luftë për pushtet. Me të vërtetë, ka shumë spekulime se në mesin e demonstruesve kishte elementë të cilët këtë situatë e kishin në mendje si një motiv për të krijuar shqetësime sot. Ka disa të dhëna për përfshirjen në demonstrata të kosovarëve të kthyer që kanë punuar jashtë vendit të cilët mund të kenë qenë në kontakt me organizata shqiptare emigrantësh që kërkojnë ndryshimin e vetëregjimit në Shqipëri. Raporte mbi protestat e emigrantëve në pjesë të ndryshme të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara tregojnë të paktën mbështetje morale për demonstruesit e Kosovës.

10. Ka të ngjarë që këto shkaqe politike janë bërë më të dukshme nga ankesat ekonomike dhe sociale. Me gjithë përpjekjet e konsiderueshme për zhvillimin e Kosovës me ndihma nga Fondi Federal për zonat e pazhvilluara dhe kohët e fundit me investime direkte nga Republikat dhe ndërmarrjet individuale, Krahina ka mbetur ende prapa në çdo aspekt (përveç lindshmërisë fenomenale!). Perspektivat për punësim nuk kanë ndjekur të njëjtin ritëm me aspiratat e një numri tejet të lartë të rinjsh që lënë shkollën apo universitetin, të cilët meqenëse janë arsimuar kryesisht në gjuhën shqipe, nuk kanë të njëjtën lëvizshmëri për të gjetur punë tjetërkund në Jugosllavi. Kështu, popullsia kaloi nga 733,000 veta në vitin 1948 në 1,566,000 veta në vitin 1979, nga të cilët 382,000 ishin në shkollë dhe 47,497 ishin në universitet, ndërkohe që vetëm 168,000 ishin punësuar në sektorin social. Mungesa e punës nuk i ka penguar njerëzit, veçanërisht fshatarët me arsim të ulët, që të vërshojnë në Prishtinë dhe qytete të tjera, të cilat janë shumë të mbushura dhe mezi përballojnë problemet e panumërta sociale.

11. Një tjetër faktor, që po del në dritë, ishte dështimi i udhëheqjes lokale për të dëgjuar paralajmërimet për pakënaqësinë në rritje në mesin e studentëve dhe, natyrisht pas shpërthimit të parë më 11 mars, për të marrë masat e duhura korrigjuese. Kolegu im gjerman më tha se udhëheqësit e lartë të Partisë i folën për këtë z. Willy Brandt gjatë një vizite të fundit në Beograd, duke nënkuptuar se vetë Bakalli, kryetar i Lidhjes së Komunistëve në Kosovë,

ishte keqinformuar dhe i kënaqur. Pasojat

12. Megjithëse ndoshta do të duhet kohë që të shfaqen pasojat e brendshme politike, ka të ngjarë që të ketë ndryshime në udhëheqjen e Kosovës për shkak të trajtimit të dobët të ngjarjeve nga ana e saj. Është pranuar qartazi nga udhëheqja e Partisë se shkaqet shtrihen jo në kërcënimin e jashtëm, por "në vetë dobësitë tona, në zhvillimin e pamjaftueshëm të sistemit socialist të vetëmenaxhimit." Lidhja e Komunistëve dhe organizata të tjera socio-politike po analizojnë se si ishte e mundur që ata të jenë zënë në befasi dhe të kenë llogaritur gabim shenjat e para të trazirave politike. Por, cilado qofshin rezultatet e këtyre kërkimeve, konkluzioni i pashmangshëm është se përsëri udhëheqja e Kosovës tregoi shenja paafësie për të zgjidhur dilemën e vjetër që të përfaqësojë aspiratat kombëtare të Krahinës së saj duke iu përmbajtur vijës së Partisë e cila nuk pranon asnjë ndryshim themelor në statusin e Kosovës.

13. Duke u nisur nga çdo kriter logjik, Kosova brenda kufijve të saj aktualë, duhet të ketë status të barabartë në Jugosllavi me republikat e Malit të Zi, Sllovenisë dhe Maqedonisë, meqenëse popullsia e saj është po aq e madhe dhe etnikisht homogjene sa ç'është secila prej tyre. Por, udhëheqja jugosllave ka refuzuar me vendosmëri që t'i hapte rrugë një logjike të tillë për arsye të brendshme politike dhe të sigurisë. Menjëherë pas Luftës, Partia nuk dëshironte t'i kundërvihej serbëve më tej duke shpëputur Kosovën, meqenëse këta të fundit e kishin "humbur" tashmë Maqedoninë dhe Bosnjën e Hercegovinën nga Serbia e Madhe e paraluftës. Kosova, si zemra e mbretërisë mesjetare serbe e shkatërruar nga turqit në vitin 1389, ka qenë atëherë dhe sot, në gjendje të trazojë ndjenjat e forta në radhët e serbëve. Për më tepër, pas vitit 1948

Shqipëria ka qenë një vend armiqësor dhe Jugosllavia nuk mund të rrezikonte të kishte një Republikë shqiptare më vete në Kosovë e cila mund të tjetërsohej. Duke miratuar një politikë të tillë, Partia ishte e detyruar të ndiqte atë pa kompromis që atëherë, sepse ndryshimi i saj tani do të thoshte hapja e Kutisë së Pandorës me kërkesa të tilla: së pari, nga komunitetet e konsiderueshme shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi për t'u bashkuar me Republikën e Kosovës; më pas nga Krahina Autonome e Vojvodinës për barazi, gjë që do të shqetësonte serbët si aty dhe në Serbi; dhe, përfundimisht, për rishikimin e kufijve të Republikave për të marrë parasysh dëshirat e pakicave. Siç është shprehur Dolanc, anëtar i Kryesisë së Partisë: "Krijimi i një Republike do të thoshte absolutisht pa dyshim një sulm për integritetin e Jugosllavisë". Dhe Sekretari i Partisë, Dragosavac, tha pa mëdyshje: "Çështja e Kosovës është zgjidhur, ajo është pjesë integrale e Serbisë dhe Federatës Jugosllave."

14. Kështu, duket se jemi edhe një herë dëshmitarë të një situatë klasike të një force të parezistueshme të nacionalizmit që ndeshet me objektin e patundur të politikës zyrtare. Diçka, diku duhet të japë: problemi i Jugosllavisë duhet të vendosë se çfarë. Në të kaluarën, Jugosllavia ia ka dalë pas çdo shpërthimi të nacionalizmit në Kosovë që të qetësojë situatën duke ofruar lëshime kushtetuese të cilat në tërësinë e tyre i kanë dhënë Kosovës praktikisht statusin e Republikës. Vështirë të kuptohet - siç e pranojnë privatisht vetë udhëheqësit e Partisë - se sa larg ata mund të shkojnë menjëherë pas dhënies së statusit të Republikës. Por, nuk kam dyshim se ekspertët e zgjuar kushtetues të Jugosllavisë do ta rishqyrtojnë problemin.

15. Ndërkohë, një pjesë tjetër e aparatit të Lidhjes së Komunistëve është duke shqyrtuar gabimet që kanë zbuluar këto ngjarje në

sistemin e informimit publik. Shtypi, i drejtuar nga disa kryeartikuj sarkastikë në gazetën "Politika", është i mbushur me kritika për vonesa në sigurimin e informacioneve për atë që ka ndodhur në të vërtetë. Megjithëse sipas standardeve të shtypit të vendeve të tjera komuniste ngjarjet janë dokumentuar mjaft mirë, Kosova, dhe në të vërtetë autoritetet qendrore, ngurronin fillimisht të tregonin ndonjë gjë si ngjarje të plotë. Për shembull, një ditë pas përlëshjeve të 1 prillit në Prishtinë, shtypi kishte të nesërmen vetëm një përmbledhje tepër të shkurtër të raporteve. Asnjë televizion nuk u lejua që të pasqyronte ngjarjet direkt. Siç e vunë në dukje shumë njerëz: "Ne jemi informuar më shumë për Brikston se për Kosovën"! Gazeta "Politika" u ankua se bllokimi fillestar dhe kufizimet e mëvonshme nuk ishin zgjedhje e medias. Në qarqet politike po bëhen pyetje për rolin e medias dhe detyrimin e saj për të informuar menjëherë publikun për çështje që kanë interes legjitim, të cilat mund të kenë rëndësi të konsiderueshme për zhvillimet e mëtejshme në Jugosllavi.

16. Nga ana e jashtme, pasoja kryesore politike ishte përkeqësimi i marrëdhënieve ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë pas një përmirësimi të qëndrueshëm gjatë dy viteve të fundit. Udhëheqja jugosllave ishte e kujdesshme në deklaratat e saj publike për të shmangur implikimin e Shqipërisë. Ky qëndrim ndryshoi pas artikullit të udhëheqësit në gazetën "Zëri i Popullit" i datës 8 prill, gjë që u denoncua si ndërhyrje në çështjet e brendshme për t'i ofruar mbështetje nacionalistëve dhe për t'i nxitur ata në revolta të hapura. Megjithatë, është e qartë se Jugosllavia nuk ka dëshirë të reagojë më shumë se kaq. Natyrisht Jugosllavia nuk mund t'i kalojë në heshtje komentet e formuluar me zgjuarsi nga shqiptarët për ngjarjet, por u përpoq t'i përgënjeshtronte akuzat për neglizhencë dhe

prapambetje në Kosovë dhe të tregonte vendosmërinë e saj për të trajtuar çdo pretendim ndaj integritetit territorial të saj. Kjo nuk i ka dhënë fund tregtisë së mbarë dhe lidhjeve kulturore ndërmjet dy vendeve, të cilat u ruajtën gjatë gjithë kohës së ngjarjeve, por marrëdhëniet politike kanë të ngjarë të mbeten të ngrira për një periudhë të gjatë në vazhdim.

17. Ndërkohë, autoritetet përleshën me problemet imediate për ndreqjen e situatës. Kështu është vënë re një fillim për përmirësimin e kushteve për studentët në Universitetin e Prishtinës dhe janë marrë masa të tjera afatshkurtra të tilla si ulja e çmimeve të disa produkteve ushqimore bazë. Udhëheqësit politikë nuk janë duke u përqendruar në masat afatgjata. Anëtarët e Lidhjes së Komunistëve i janë kthyer me vendosmëri rregullit dhe organizata të tjera politike dhe shoqërore janë duke marrë masa për të rikthyer linjën zyrtare. Gjatë pesë viteve të ardhshme Kosova do të marrë rreth 20 miliardë £ për zhvillimin e ekonomisë dhe shërbimeve sociale nga Fondi Federal, ku pjesa e saj është rritur nga 30 deri në 40%. Sipas Planit të ri 5-vjeçar, Kosova do të marrë gjithashtu fonde të tjera në një shkallë më të gjerë se kurrë më parë gjë që do të mundësojë një zgjerim të madh në arsim, kulturë dhe shëndetin publik, ngritjen e 40,000 apartamenteve të reja dhe ndërtimin ose zgjerimin e fabrikave industriale, veçanërisht për të shfrytëzuar burimet energjetike dhe pasuritë minerale të Kosovës, duke ofruar kështu më shumë punë dhe një normë rritjeje prej 60% mbi mesataren jugosllave. Përmbledhje

18. Ngjarjet në Kosovë erdhën si një zgjim i ashpër ndaj udhëheqjes jugosllave në përfundim të vitit të parë të saj pa Titon. Sidoqoftë, këto ngjarje nxorën në pah jo një problem të ri, por një problem endemik, të cilin as vetë Tito nuk kishte mundur ta zgjidhte me gjithë autoritetin dhe karizmin e tij. Po

kështu, as udhëheqësit aktualë, siç e pranojnë edhe vetë, nuk mund t'i japin zgjidhje këtij problemi. Por në këtë rast ata treguan, pas befasisë së fillimit, një pjekuri për t'u përshëndetur për mënyrën e përmbajtur dhe pozitive me të cilën e trajtuan situatën. Me një përdorim minimal të forcës, ata vunë me shpejtësi nën kontroll trazirat dhe nuk lejuan që të përfshihej i gjithë populli i Kosovës. Ky qëndrim së bashku me refuzimin e tyre për të pranuar thirrjet për përdorimin e "dorës së fortë" dhe në vend të kësaj, për të vazhduar me rrugën e zgjedhur drejt demokratizimit më të madh, ofrojnë argumente të arsyeshme për të besuar se udhëheqja do të jetë në gjendje që të mbajë Federatën të bashkuar.

19. A ka të ngjarë që ngjarjet në Kosovë të ndikojnë tek ne? Këto ngjarje ndikojnë në masën që autoritetet jugosllave mund të pritët të tregojnë rritje të shqetësimit të tyre në lidhje me unitetin dhe integritetin territorial të tyre, dhe për pasojë një ndjeshmëri më të mprehtë ndaj nacionalizmit si forcë përçarëse, e më në veçanti të shprehur në aktivitetet e emigrantëve apo fqinjëve të tyre. Nga ana jonë, pak gjë mund të bëhet në përmbushjen e kërkesave të jugosllavëve për të përmbajtur emigrantët e tyre armiqësorë dhe nuk kemi ndërmend të përfshihemi në mosmarrëveshjet lokale ballkanike. Por, me deklaratën e saj të vendosur vitin e kaluar mbi vlerën që i japim integritetit territorial dhe pavarësisë së vendit të tyre, Kryeministria jonë i dha shumë kënaqësi jugosllavëve. Vizita e ardhshme në Londër në qershor e sekretarit të Jashtëm, z. Vrhovec, do të në japë një mundësi tjetër për të riafirmuar këtë mbështetje.

20. Këtë informacion po jua dërgoj përfaqësuesve të Madhërisë së Saj në Uashington, Moskë, Athinë, Sofje, Bukuresht, Budapest, Romë, Bon, Paris, përfaqësuesit të përhershëm të Mbretërisë së



Bashkuar në Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe Konsullit të Përgjithshëm të Madhërisë së Saj në Zagreb.

*Mbetem, Shkëlqesia Juaj,
I Juaji besnikërisht,
E. Bolland*

-16-

Për përdorim të kufizuar

J C R Gray Esq
Ambasada britanike
Beograd
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtme dhe e Komonuelthit
28 prill 1981
I nderuar Alan,
Studentët

1. Bashkangjitur po ju dërgoj një kopje të një promemorie të Charles Crawford ku përmbledhen disa nga zhvillimet më të fundit të jetës studentore e cila në një farë mase pasqyrore trazirat e studentëve në Kosovë. Këto zhvillime vlen të regjistrohen, meqenëse tregojnë shqetësimin e dukshëm gjithnjë në rritje të autoriteteve që pakënaqësia e studentëve për kushtet e tyre dhe perspektivat e tyre të punësimit nuk duhet të dalë jashtë kontrollit.

2. Do të ishte tunduese të konkludohej se seria e artikujve ndaj të cilëve Charles Crawford është frymëzuar tërësisht nga demonstratat studentore në Kosovë. Megjithëse këto ngjarje padyshim që kanë theksuar problemet e studentëve, ato nuk janë kurrsesi ngjarje të reja. Megjithatë, këto ngjarje kanë ardhur duke u përkeqësuar ndërkohë që situata e përgjithshme ekonomike në Jugosllavi dhe më gjerë është përkeqësuar dhe është rritur qartazi presioni për të bërë diçka për to. Aksioni vazhdon në tre fronte: së pari, për të përmirësuar kushtet e punës dhe të jetesës së studentëve; së dyti, për të përmirësuar perspektivat e punës në aspektin afatgjatë duke e përshtatur më shumë arsimin e nevojat e shoqërisë; dhe së treti, "për të angazhuar" studentët në mënyrë më të plotë në jetën politike.

3. Detyra e autoriteteve nuk do të jetë e lehtë meqenëse fondet janë të limituara, por ka filluar puna për përmirësimin e kushteve të studentëve. Vetë studentët duket se nuk janë të gatshëm të krijojnë trazira; në të vërtetë, një prej problemeve është se ata duken të pa interesuar për politikë të çfarëdo lloji. Aktualisht nuk ka shenja se trazirat në Prishtinë po përhapen në Universitete të tjera.

P. Rosling Esq; Zagreb
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO
I Juaji,
T. J. Clark

-17-

Për përdorim të kufizuar

Këshilltarë
Studentët

1. Një pasojë që vlen të përmendet (por jo e paparashikueshme) e rolit kryesor që kanë luajtur studentët e pakënaqur në trazirat e ngjarjeve në Kosovë ka qenë një valë e madhe e interesit zyrtar dhe shtypit në

çështjen e standardeve të përgjithshme të jetesës së studentëve. Vetëm në gazetën "Politika" ka pasur shtatë pjesë thelbësore që prej fundit të marsit mbi problemet financiare, të akomodimit dhe punësimit me të cilat po përballen studentët; gjithashtu gazeta "NIN" e datës 19 prill ka publikuar një intervistë me dr. Jovo Jariç, kryetar i Konferencës së Universitetit të Lidhjes së Komunistëve të Universitetit të Beogradit, në të cilën ai foli gjerësisht për të njëjtat çështje.

2. Nga një koincidencë e papritur, të nesërmen e demonstratave kryesore në Prishtinë, më 1 prill, të cilat gazeta "Politika" mezi i raportoi, kjo e fundit kishte dy artikuj të gjatë mbi nevojën për të përmirësuar standardet e jetesës së studentëve. Një artikull i datës 30 mars, raportonte një propozim të bërë për rritjen prej 10% të kredisë studentore dhe ngrirje të çmimit për shpenzimet e ushqimit dhe strehimit në Universitetin e Beogradit deri në fund të vitit akademik. Artikuj të tjerë bënin fjalë për problemet e punësimit të të diplomuarve (4 prill); përmirësimet e ndihmës financiare dhe perspektivat e punësimit (9 prill); një studim të kushteve të jetesës së studentëve në Mostar (11 prill); libra më të lirë shkollorë për studentët (20 prill); dhe, në terma më ideologjike, nevojën për "unitet" ndërmjet studentëve dhe mësuesve (21 prill). Dy çështjet e gjera të standardeve të jetesës për studentët dhe perspektiva për punësimin e tyre vlejnjë të shqyrtohen sepse janë shkak për shqetësime në klimën aktuale ekonomike dhe politike.

3. Situata financiare dhe standardet e jetesës së studentëve. Duke folur gjerësisht, tarifa e shkollimit të një studenti jugosllav do të paguhet nga Republika por, nëse të ardhurat e përgjithshme familjare nuk janë krejt të ulëta, pritet që familja të përmbushë plotësisht shpenzimet e përditshme të jetesës. Inflacioni i kohëve të fundit ka rritur problemet me të cilat përballen familjet në këtë drejtim (Studentët mund të marrin kredi për të ndihmuar që të paguajnë shpenzimet e tyre. Nëse ecin mirë, zakonisht kreditë anulohen, dhe nëse ecin keq, ata duhet të ripaguajnë të gjithë kredinë). Për më tepër, mungesa dhe shpenzimi i akomodimit të përshtatshëm për studentët nënkuptojnë se shumë studentë në Beograd dhe pa dyshim, edhe në qytete të tjera të universiteteve, jetojnë në shtëpi: pozita e studentëve të cilët kanë ardhur nga fshati dhe nuk mund të marrin dhomën e tyre në konviktet e mbushura studentore nuk është për t'u patur zili. Studentët në konvikte kanë vepruar për të ndihmuar shokët e tyre dhe vetë xhepin e tyre duke thyer rregullat në ndarjen e dhomave të kolegjit dhe duke ndarë së bashku qiranë. Sipas gazetës "Politika" ka rreth 3,000 "ilegalë" në hollat e banimit të Universitetit të Beogradit, pa dyshim një nënvlerësim për shifrat e cituara në intervistën e paraqitur në gazetën "NIN" me dr. Jariç ku shprehet për rreth 11,000 vende në konviktet studentore për pak a shumë 100,000 studentë në "qytetin e madh Universitar" të Beogradit. Sidoqoftë, ndarja e dhomës së konviktit nuk mund të



jetë diçka e rehatshme meqenëse hapësira zyrtare fiktive e sipërfaqes për studentë (e cituar në të njëjtin artikull) është çuditërisht e saktë, por, gjithsesi, me kursim prej 7.38 m2.

4. Artikulli i gazetës "Politika" ku paraqiten rezultatet e një studimi të universitetit mbi standardet e jetesës së studentëve në Mostar, dha disa detaje reale. Nga 3,500 studentët e Mostarit, dy të tretat e tyre shkojnë e vijnë me makinë në Mostar, mesa duket nga shtëpia. Konvikti ofron dhoma për 225 studentë, por është duke u ndërtuar një aneks i ri. Pjesa tjetër e studentëve, ose jetojnë me prindërit e tyre në qytet, ose kanë marrë dhoma me qira, plus fletja dhe ushqimi që shkojnë diku ndërmjet 800 dinarë (rreth 11.30£) dhe 1900 dinarë (rreth 26.80£) në muaj. Kjo shifër duket mjaft e lirë sipas standardeve tona, por, meqenëse paga mesatare është rreth 7 000 dinarë në muaj, nuk duhet të jetë e lehtë të paguash çerekun apo më shumë të rrogës për të mbajtur djalin apo vajzën student.

5. Perspektivat për punë të studentëve. Siç raportoi gazeta "Politika" (14 prill), vitin e kaluar u regjistruan 5,312 studentë të Beogradit, për të kërkuar punë. Megjithëse 3,366 e të diplomuarve kishin gjetur punë, ky numër ishte pothuajse 1,000 më pak sesa numri në të njëjtën kohë në vitin paraardhës. Raporti shtonte: "Në mënyrë simptomatike, në mesin e studentëve të punësuar me diplomë universitare, ka rreth 1,340 inxhinierë të papunë". Në diskutimin e këtij problemi në Komitetin Ekzekutiv të Kuvendit serb, më 8 prill, një delegat raportoi se çdo ditë ishin marrë kërkesa nga punonjës në vështirësi që kërkonin të çliroheshin nga detyrimet e tyre ligjore për të punësuar "praktikantë". "Natyrish, këto kërkesa u refuzuan". Sidoqoftë, nëse punonjësit ndjekin shembullin e Universitetit të Beogradit, ata thjesht nuk do të marrin parasysh detyrimet e tyre. Siç e pranoi dr. Jariç në gazetën "NIN", gjatë dy viteve të fundit nuk është marrë asnjë asistent pedagog në Universitet për arsye të mungesës së fondeve.

6. Duhet shtuar se vetë procesi akademik në fakt e fsheh normën e vërtetë të papunësisë. Megjithëse kursi i zakonshëm i diplomimit

normalisht zgjat katër vjet, është normale për një student në Beograd që të bëjë shtatë vjet për t'u diplomuar, pasi është e domosdoshme që të marrë provimet e fundvitit me qëllim që të kalojë në punën e kursit të vitit pasardhës; dështimi në provime nënkupton detyrimin për përsëritjen e tyre, gjë që zakonisht sjell humbjen e një viti akademik, dhe kjo nuk ndodh vetëm një herë. Në të vërtetë, duket se nuk janë të rrallë numri i studentëve 30-vjeçar, të cilët janë sjellësi të papunë për 10 vjet (!) në përpjekje prej Sizifi për t'u diplomuar. Statistikat e papunësisë janë shtrembëruar më tepër nga mos dëshira e studentëve të diplomuar për të kërkuar punë jashtë Beogradit. Kështu, ndërkohë që në zonat rurale mungojnë mjekët, në Beograd ka me tepri prej tyre.

7. Duke lënë mënjanë çështjen e shtrembërimit të statistikave, zyrtarisht nuk ka shpresë për përmirësim në këtë zonë. Të dy artikujt e gazetës "Politika" dhe dr. Jariç, theksuan nevojën për të zbatuar ligjet që mbulojnë punësimin e punëtorëve të rinj, por edhe nëse punonjësit punësojnë pa dëshirë të diplomuarit, kur ata vërtetë nuk janë të nevojshëm, rezultati përfundimtar është thjesht zhvendosja e shpenzimeve të papunësisë dhe nën punësimin nga xhepat e prindërve në ndërmarrjet në vështirësi. E thënë ndryshe, të diplomuarit thjesht do të duhet të presin që ekonomia jugosllave të marrë veten sërish. Sidoqoftë, në aspektin afatgjatë do të jetë me interes të shihet nëse autoritetet do të përpiqen të reformojnë të gjithë strukturën e arsimit të lartë dhe të shtrëngojnë procedurat mjaft tolerante të hyrjes në universitete, për shkak të fondeve të pamjaftueshme për zgjerim të mjaftueshëm dhe përmes hezitimit zyrtar për të subvencionuar një numër të madh studentësh 25-vjeçar të pamotivuar dhe përbuzës. Dr. Jariç la të kuptohet ky fakt kur intervistuesi i tij tha se askush nuk kishte dëgjuar kur universitetet kishin paralajmëruar kundër zgjerimit të mëtejshëm të arsimit të lartë: "Kemi arritur një pikë kritike - decentralizimi i arsimit të lartë është natyrisht i mirëpritur, por aspektet pozitive kanë sjellë me vete një valë ambiciesh

megalomanie".

8. Implikimet politike. Megjithëse shpërthimi i trazirave në Kosovë duket se paralajmëron që nuk do të lejohet përkeqësimi i mëtejshëm i standardeve të jetesës së studentëve, rëndësia e trazirave qëndron kryesisht në ndjenjën e nacionalizmit e kombinuar me vështirësitë më të mëdha sociale të shkaktuara nga një zhvillim i shpejtë në vetë krahinën e prapambetur të Kosovës, sesa në pakënaqësinë e drejtpërdrejtë të studentëve. Natyrisht që trupa studentore në Beograd duket në përgjithësi e qetë, megjithëse gazeta e saj "Studenti", po bëhet gjithnjë e më aktive, dhe askush nuk shikon asnjë shenjë të acarimit ekstrem të krahut të majtë të atij lloji që tronditi Beogradin në vitin 1968. Një gazetar që takuam në Zagreb, kur shoqërova Judith Brown me rastin e largimit të saj në mars, nënqeshi me apatinë dhe plogëshinë e studentëve aty. Disa vëzhgues më pak cinikë ia atribuonin këtë qëndrim faktit që studentët e kishin kuptuar se punët e mira është vështirë të gjendjen pa pasur diplomë të mirë dhe dosje të pastër. Në konferencën e Komitetit Qendror të LKJ-së së Serbisë që u mbledh për të diskutuar rolin e 64,000 studentëve komunistë në mes 220,000 studentëve të Serbisë, Kosovës dhe Vojvodinës (gazeta "Politika", 21 prill), "u bë thirrje për përpjekje më të mëdha, organizim më të mirë dhe veprim shoqëror më të gjerë" të mësuesve dhe studentëve komunistë për t'ju kundërpërgjigjur "pasivitetit" dhe për të mbyllur "hendekun klasik" midis studentëve dhe mësuesve. Fakti që LKJ-ja nuk ka vend për vetëkënaqësi për përpjekjet e saj informuese, u shfaqën në vërejtjen e profesor Vladimir Bovana, i cili raportoi në gazetën "Politika" më 8 prill: "Studentët tanë (në Kosovë) nuk dinë asgjë (!) për, le të themi, planin 5-vjeçar të zhvillimit për Kosovën..."

9. Mendimi im është se situata e përgjithshme ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi do të përkeqësohet në mënyrë drastike para se të zhvillohen trazira sistematike të studentëve në një shkallë të rëndësishme.

I Juaji,
Charles Crawford
27 prill 1981

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Presidenti Ademi viziton Kombëtaren gjatë stërvitjes: Fillimi i ri

PRISHTINË, 20 MARS - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka thënë se Kombëtarja e Kosovës po nis një fillim të ri. "Fillimi i ri për Kombëtaren tonë! Me stafin e ri të trajnerëve të Kombëtares për një mision të ri. Së bashku po e nisim një rrugëtim të ri, i cili besojmë se do të na çojë drejt suksesit e lavdisë në skenën

ndërkombëtare të futbollit. Gjatë këtyre ditëve stafi i trajnerëve në krye me Franco Fodën kanë punuar me shumë zell dhe vendosmëri që ekipi ynë dardan ta përfaqësojë me dinjitet flamurin e Kosovës në çdo ndeshje e në çdo garë", ka shkruar Ademi në "Facebook". Ademi ka thënë se është krenar

me ekipin kaq të talentuar dhe të përkushtuar të futbollistëve "dardanë". "Jam krenar që kemi një ekip kaq të talentuar dhe të përkushtuar të futbollistëve dhe jam i bindur se kjo fazë e re do të na sjellë momente të mrekullueshme dhe suksese të mëdha në rrugëtimin tonë", ka shtuar presidenti Ademi.



Aliti dhe Rrahmani: Na presin dy ndeshje të rëndësishme

Futbollistët Fidan Aliti dhe Albion Rrahmani kanë vlerësuar se ndeshja miqësore ndaj Armenisë dhe ajo ndaj Hungarisë janë shumë të rëndësishme për faktin se futbollistët do të njihen nga afër me trajnerin Franco Foda, por edhe për t'u përgatitur për ndeshjet e Ligës së Kombeve që fillojnë në muajin shtator

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka mbajtur seancën e fundit stërvitore në Kampin Nacional në Hajvali. Përzgjedhësi Franco Foda në këtë stërvitje ka punuar intensivisht në aspektin taktik dhe transformimin e reparteve, teksa kishte në dispozicion të gjithë futbollistët e ftuar për dy miqësoret e muajit mars.

Mbrojtësi me përvojë të madhe në formacionin e "dardanëve", Fidan Aliti, pas stërvitjes, ka thënë se shpreson për rezultate pozitive në këto ndeshje miqësore dhe beson se ato, së bashku me ndeshjet e ardhshme në qershor, do të ndihmojnë në njohjen e filozofisë

së trajnerit të ri. Ai, gjithashtu, vlerësoi cilësinë e Hungarisë, duke shtuar se fakti që është në Kampionatin Evropian, tregon për kualitetin e saj. "Shpresojmë në rezultate pozitive. Besoj që këto dy miqësore dhe ato në qershor do të na shërbejnë ta njohim filozofinë e trajnerit, por edhe ai të na njohë neve. Besoj se e ardhmja na pret me suksese. Hungaria ka një ekip me lojtarë me kualitet dhe do të shkojë në Evropian. Kjo është veç një ndeshje miqësore dhe do të jetë vetëm hap i parë për suksese. Kemi punuar shumë taktikisht dhe trajneri na ka treguar se si dëshiron të luajë me ne", ka thënë Aliti. Pas stërvitjes ka folur edhe sulmuesi Albion Rrahmani, i cili është rikthyer në Përfaqësuesen e Kosovës pas lëndimit. Ai është



shprehur i lumtur që sërisht u është bashkuar "dardanëve", derisa ndeshjet i ka vlerësuar shumë të rëndësishme edhe për faktin se janë miqësore. "Jam shumë i lumtur që përsëri jam pjesë e Kombëtares pas lëndimit. Jam rikthyer në formën time më të mirë

të mundshme dhe jam i gatshëm të jap 100 %. Edhe pse janë miqësore, janë ndeshje të rëndësishme, por do të na shërbejnë më shumë për ta njohur trajnerin, taktikat e tij dhe të gjithë bashkëlojtarët njëri-tjetrin me taktika të reja. Shpresoj të dalim me

rezultate pozitive pasi do të jenë shtysë e madhe për neve për të qenë sa më të gatshëm për ndeshjet në shtator", ka thënë Rrahmani. Kosova më 22 mars do të përballet me Armeninë, kurse më 26 mars do të përballet me Hungarinë.

Sot është shorti i kualifikimeve për 'Euro 2026'



Prishtinë, 20 mars - Hendbollistët e Përfaqësueses së Kosovës sot (enjte) i mësojnë kundërshtarët në fazën kryesore kualifikuese për Kampionatin Evropian 2026. Shorti tërhiqet nga ora 16:30 në Kopenhagë, ku mbahet edhe konferenca e sekretarëve gjeneralë të federatave nacionale, anëtare të EHF-së. Danimarka, Suedia dhe Norvegjia e organizojnë Evropianin e ardhshëm dhe kualifikohen drejtpërdrejt, njëjtë si Franca, që është kampione aktuale. 32 ekipe

kombëtare garojnë në kualifikimet e rregullta për 20 bileta të Evropianit. Do të formohen tetë grupe me nga katër kombëtare. Dy të parat nga secili grup kualifikohen, po ashtu katër prej tetë kombëtareve më të mira të vendeve të treta. Për short, Kosova është në vazon e katërt. Kualifikimet për "Euro 2026" fillojnë më 6 nëntor të këtij viti dhe përfundojnë më 11 maj të vitit 2025. Kosova tashmë e ka përvojën në kualifikimet e rregullta dhe do ta kërkojë suksesin.

VAZO 1 Gjermania, Spanja, Hungaria, Kroacia, Islanda, Sllovenia, Portugalia, Holanda
VAZO 2 Austria, Mali i Zi, Serbia, Polonia, Çekia, Maqedonia e Veriut, Ishujt Faroe, Greqia
VAZO 3 Bosnjë-Hercegovina, Sllovakia, Belgjika, Zvicra, Rumania, Lituania, Ukraina, Italia
VAZO 4 Finlanda, Izraeli, Estonia, Gjeorgjia, Turqia, Luksemburgu, Kosova, Letonia

IOC përjashton atletët rusë dhe bjellorusë nga ceremonia e hapjes

Paris, 20 mars - Në mbledhjen e fundit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar është vendosur se atletët rusë dhe bjellorusë nuk do të jenë pjesë e ceremonisë së hapjes në "Paris 2024". Atletët në

fjalë nuk do të marrin pjesë në këtë event me flamujt respektivë, por do të garojnë si atletë neutralë. Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach,

ka bërë zyrtar vendimin e marrë ditën e djeshme gjatë mbledhjes së radhës të institucionit. Mësohet se ceremonia e hapjes së "Paris 2024", e cila do të mbahet në 26 korrik, do të jetë

ndryshe nga ato që kemi parë në olimpiadat paraardhëse. Këtë vit mijëra atletë nuk do të shfaqen në stadium, siç është tradita, por do të lundrojnë në lumin e Senës drejt kullës Eifel.



Seferi: Të gjithë më donin te Maqedonia, por ëndrra ime ishte fanella kuqezi

Tiranë, 20 mars - Taulant Seferi është aktivizuar me të rinjtë e Maqedonisë së Veriut përpara se të bashkohej me Shqipërinë U21. Më pas, sulmuesi luajti dy ndeshje me maqedonasit, për të veshur më pas fanellën e kombëtares

së madhe kuqezi. "Te Maqedonia kisha kaluar të gjitha grupmoshat e reja deri tek ekipi A. Aty arrita edhe një rekord dhe të gjithë më donin me çdo kusht. Por, dëshira dhe ëndrra ime gjithmonë ka qenë fanella kuqezi dhe për këtë

përzgjedhje që kam bërë, jam shumë krenar. Dua ta falënderoj Alban Bushin, i cili e ka marrë iniciativën, më ka lajmëruar në telefon, duke më dërguar ftesë për Kombëtaren e Shqipërisë dhe e ka bërë ëndrrën time realitet.

Momenti kur më ka marrë në telefon ishte, kur isha në veturë duke udhëtuar së bashku me menaxherin tim dhe pa u menduar dy herë, i kam thënë po", ka thënë Seferi në një intervistë dhënë për "Podcast me Bujar Osmani".



Liga Unike Femrat, triumfojnë Penza, Prishtina dhe Bashkimi

PRËTË, 20 MARS - Penza ka siguruar "play-off"-in në Liga Unike Femrat. Skuadra pejane ka mundur Partizanin 82:76 (27:10, 17:28, 21:11, 17:27) në javën e nëntë. Me këtë fitore pejanet siguruan një vend në "play-off", që do të mbahet më 1 dhe 2 prill në Kosovë. Vendaset e nisën ndeshjen më mirë dhe fituan bindshëm çerekun e parë 27:10, derisa ngritën më shumë epërsinë në periodën e tretë. Mysafiret tentuan rikthimin në dhjetë minutat e fundit, por nuk ia aritën qëllimit dhe Penza fitoi 82:76. Te skuadra pejane u dalluan Saranda Daci me 20 pikë dhe dhjetë kërcime, Peavy Elise me 20 pikë dhe 11 kërcime dhe Sara Vrasniqi me 20 pikë dhe nëntë kërcime, kurse te skuadra tiranase u dalluan Antoinette Bennister me 20 pikë, gjashtë kërcime dhe dhjetë asistime, Emma Fee me 18 pikë e shtatë kërcime dhe Ornela Lalaj me 18 pikë dhe 13 kërcime. Penza ka katër fitore e pesë humbje, kurse Partizani një fitore dhe tetë humbje. Prishtina ka shënuar fitore ndaj Flamurtarit të Vlorës me rezultat



52:63 (9:6, 19:23, 12:13, 12:21). Karon Williams ishte më e mira te vendaset me 15 pikë e katër kërcime, kurse te mysafiret Jaccqueline Castro kishte 14 pikë e dhjetë kërcime dhe Jade Williams kishte 14 pikë e 14 kërcime. Flamurtari ka dy fitore dhe shtatë humbje, kurse Prishtina shtatë fitore dhe dy humbje. Bashkimi ka shënuar fitoren e nëntë në nëntë ndeshje të zhvilluara në Liga Unike Femrat, njëherësh skuadra e vetme pa humbje dhe do ta fillojë "play-

off"-in nga vendi i parë. Prizrenaset kanë shënuar fitore ndaj Tiranës me shifrat 68:85 (25:23, 17:19, 12:22, 14:21). Maggie Justinak kishte 17 pikë te vendaset, ndërsa Enisa Qosja shtoi 15 pikë, e te mysafiret më të mirat ishin Adrienne Godbold me 35 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime, Aulona Muhadri me 28 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime dhe Arbnore Përçuku me dhjetë pikë, tetë kërcime dhe 14 asistime.

Denveri fiton duelin e kreut në Perëndim, triumfojnë edhe Dallasi dhe Houstoni



WASHINGTON, 20 MARS - Denveri mposhti me rezultat 115-112 Minnesotan në përballjen e dy prej skuadrave më të mira në Konferencën e Perëndimit dhe NBA-s. Një sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku të dyja ekipet u përballën për fitore. Nikola

Jokiçi, me 35 pikë e 16 rebounde, ishte lider për Denverin, mbështetur edhe nga Porteri me 26 pikë. Për Minnesotan, Edwardsi realizoi 30 pikë e McDaniles 26, por që s'mjaftuan për të fituar. Dallasi fitoi me rezultat 113-107 derbin teksan

ndaj San Antonios, një sfidë ku veterani Kyrie Irving realizoi 28 pikë. Mirë u paraqit edhe Luka Doniq me një "triple double" (18 pikë, 10 rebounde, 16 asistime). Fitore të lehtë arriti ekipi i Houstonit, që mundi me rezultat 137-114 Washingtonin jashtë fushës, sfidë ku dallimin e bëri Jalen Green me 42 pikë. Ndërsa Orlando, falë 62 pikëve të realizuara nga lojtarët e stolit, mundi me rezultat 112-92 Charlotten.

REZULTATET

Orlando - Charlotte	112-92
Washington - Houston	114-137
Brooklyn - New Orleans	91-104
San Antonio - Dallas	107-113
Minnesota - Denver	112-115

Alvesi lirohet nga burgu pasi i pagoi një milion euro gjobë

Dani Alves është liruar nga burgu. Ishte Gjykata e Barcelonës ajo që vendosi ta nxjerrë nga burgu yllin e dikurshëm brazilian pasi ai e kaloi çerekun e dënimit. Ish-

futbollisti i Barcelonës i ka paguar një milion euro gjobë për ta shmangur kështu burgun prej katër vjetësh e gjysmë, si rezultat e akuzës që e rëndonte për

përdhunimin e një vajzë 23-vjeçare më 31 dhjetor të vitit 2022 në një diskotekë në Barcelonë, shkruan "Reuters". Gjykata ndërkohë i ka vendosur kushte

ish-përfaqësuesit brazilian, i cili, nëse i thyen ato, do të rikthehet në burg. 40-vjeçari i është marrë pasaporta dhe duhet të paraqitet në gjykatë çdo javë për ta vërtetuar

praninë. Ai, gjithashtu, nuk ka të drejtë t'i afrohet së paku një kilometër shtëpisë, punës apo çdo vendndodhjeje të vajzës e cila e denoncoi.

SHKURT

KH Rahoveci, gjysmëfinalisti i parë i Kupës

KH Rahoveci është gjysmëfinalisti i parë i Kupës së Kosovës në hendboll (meshkujt). "Vreshtarët" mposhtën Vushtrrinë në çerekfinale të garës për Kupë. Ndeshja në Vushtrri përfundoi me rezultat 46:22 në të mirë të skuadrës nga Rahoveci. Rahoveci ka vetëm fitore në Superligë, ndërsa ka pretendime edhe në garën për Kupë. Ndeshja nisi me seri 5:0 të Rahovecit, ndërsa pjesa e parë përfundoi 22:11 për këtë skuadër. Mali Luzha ishte më efikas te Rahoveci me nëntë gola. Shtatë i realizoi Jeton Bislimi, ndërsa gjashtë Granit Kadiri. Katër gola për Vushtrrinë i shënoi Fitim Klinaku, ndërsa nga tri Erkan Abazxhiku dhe Oltion Shabani.

Mourinho ka filluar të mësojë gjermanisht, në verë mund ta marrë drejtimin e Bayernit

Jose Mourinho te Bayern Muncheni është një opsion konkret, pasi edhe drejtori sportiv i klubit gjerman e ka lënë të hapur këtë pistë. Në fund të këtij sezoni, Thomas Tuchel do të largohet nga Bayerni. Ky fakt ka bërë që këtë periudhë të lakohen shumë emra, një prej tyre ka qenë edhe Jurgen Kloppi, por Max Eberl, drejtor i Bayernit, e ka përjashtuar si opsion: "Ne respektojmë zgjedhjen e tij". Ndërsa i pyetur për Mourinhon, Eberl la gjithçka të hapur: "Ne po ndjekim të gjithë profilet që janë të disponueshëm. Janë mbi katër trajnerë që ne po ndjekim. Mourinho po mëson gjermanisht? Këtë nuk e di", u shpreh drejtori i Bayernit.

Mitaj në 'radarin' e Juventusit

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Mario Mitaj, është në "radarin" e Juventusit, konkretisht në listën e drejtorit të "bardhezinjve", Cristiano Guintoli. Mitajn, anësozin e mbrojtjes, që aktualisht është pjesë e Lokomotivës së Moskës në Rusi, drejtuesit e "Bardhezinjve" do ta vëzhgojnë sërish, ku pritet të jenë të pranishëm në miqësoren e 22 marsit ndaj Kilit në Parma. Ndërkaq, kujtojmë se Mitaj u transferua në Rusi verën e vitit 2022 për shifrën e tre milionë eurove nga "gigantët" grek të AEK Athens, ndërsa tashmë kartoni i tij vlerësohet pesë deri në gjashtë milionë euro, i përballeshëm për Juventusin.

Hazardi: Tani po shijoj jetën, por futbolli më mungon

Eden Hazard u largua pa shumë bujë nga futbolli teksa vari këpucët në gozhdë pasi dështoi në aventurën e tij te Real Madridi. Belgu nuk ia doli në La Liga prej problemeve të shumta fizike që u bënë faktorë në karrierën e tij. Megjithatë, ish-sulmuesi shprehet se po e shijon jetën pas futbollit edhe pse i duhet t'i kontrollojë ushqimet për të mos shtuar shumë në peshë. "Do të doja të luaja më shumë, por dëmtimet fizike e bënë të pamundur këtë dëshirë. Më mungon pak futbolli, e pranoj, sidomos dhomat e zhveshjes, por tani mund të bëj atë që dua. Unë kam fëmijë dhe një familje. Mund të kthehem në Belgjikë te të afërmit e mi dhe të bëj shumë gjëra të tjera. Tani është koha për ta shijuar jetën duke pirë disa birra. Por, nuk dua të shndërrohem në një 'derrkuc'! Unë vazhdoj të jem aktiv duke luajtur tenis, vrap dhe duke luajtur futboll me miqtë e mi. Real? Ishte ëndrra ime, edhe pse kjo aventurë nuk shkoi ashtu siç do të kisha dashur. Kur shikoj prapa dhe shoh fotot e vetes veshur me fanellën e 'Los Blancos', jam ende krenar", u shpreh Hazardi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 387/1
Datë: 19.03.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës të dt. 18.02.2024 me nr. 023/24 së **Qendres së Kompetencës” - Ferizaj** shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendrës së Kompetencës” - Ferizaj, në Republikën e Shqipërisë

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarfë të mbyllur.

Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marreveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit (**KDSH ka përcaktuar datat nga 24, 25,26,27.04.2024-tri netë,katër ditë dhe preferon vendosjen në kompleksin Hotel Bonita - Durrës**).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulturo-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë , Durrës, Krujë, Berat, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
 - Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
 - Menyja
 - Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
 - Gjendja teknike e autobusëve
 - Referencat
- Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutuesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorezohen në zyrë të AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndertesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gjithëçka Beni” Sh.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Ramize Ibrahimimi dhe Egzona Mahmuti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811485061 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gjithëçka Beni” D.O.O. od Gnjilane, sa vlasnikom Ramize Ibrahimimi i Egzona Mahmuti donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811485061 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Gjithëçka Beni” L.L.C. with headquarters Gjilan, owner Ramize Ibrahimimi ende Egzona Mahmuti has come to the decision to quit its business: 811485061 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Smailj Dzafice shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Duygu Mako shpall te pavlefshme diplomën shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Fitore Morina shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Liridon Morina shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Teuta Shehu nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Luan Ajeti B.I me emër tregtar N.T. “Prima Trade” nga Prishtina, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues NUI: 810539736.

-Labinot Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10, 11, 12, 13 dhe diplomën e Sh.M.Teknike, “Nexhmedin Nixha”.

-Miranda Agaj nga Deçani shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Mjekësisë, “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

-Miranda Agaj nga Gramaqeli i Deçanit, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 1,2,3,4 të shkollës së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi Gjakovë..

-Labinot Pajaziti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “QA Technologies” Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811876054 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “QA Technologies” D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811876054 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “QA Technologies” L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 811876054 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “FreShop ARI” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812119693 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “FreShop ARI” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812119693 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “FreShop ARI” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812119693 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

